Pjesa e Përgjithshme e Transfertës së Pakushtëzuar (IP) për vitin 2024 është 1% e Produktit të Brendshëm Bruto (PBB) të parashikuar për vitin 2024, ose 24,343,110,000 lekë dhe është 2 582 milionë lekë më shumë se në vitin 2023. Gjithsej transferta e pakushtëzuar për bashkitë dhe qarqet së bashku me transfertën e pakushtëzuar sektoriale që shpërndahet nëpërmjet formulës është 27,857,682,600 lekë, pas zbritjes së fondeve për konviktet, shërbimet sociale, për rrugët rurale. Deri para vitit 2016, fondet për konviktet, shërbimet sociale dhe për disa kritere të tjera, përfshiheshin në transfertën e pakushtëzuar përfundimtare të bashkive respektive. Me hyrjen në fuqi të formulës së re të ndarjes së transfertës së pakushtëzuar, meqenëse ndarja e fondeve për këto funksione nuk ishte pjesë e formulës, për të rritur transparencën, këto fonde janë nxjerrë jashtë totalit të transfertës që ndahet me formulë. Duke filluar nga viti 2016, këto fonde paraqiten vetëm tek bashkitë përfituese si transfertë e pakushtëzuar, sikurse paraqitur në tabelën nr. 3 pjesë përbërëse e ligjit vjetor të buxhetit të vitit 2024. Në totalin e transfertës së pakushtëzuar

përfshihen edhe fondet për mirëmbajtjen e rrugëve rurale, ku nga viti 2016, kanë kaluar nga këshillat e qarqeve tek bashkitë. Gjithashtu, fondet për këtë funksion nuk ndahen sipas formulës së transfertës së pakushtëzuar dhe paraqiten të veçanta për bashkitë përfituese në tabelën nr. 3 pjesë përbërëse e ligjit vjetor të buxhetit të vitit 2024.

Në vitin 2024, në zbatim të neneve 28 dhe 37, të ligjit nr. 69, datë 21.6.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; nenit 23, të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”; nenit 23, të ligjit nr. 68, datë 27.4.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, vazhdon reforma e sistemit të financimit të arsimit parashkollor duke e harmonizuar sistemin me praktikat më të mira ndërkombëtare në financimin e kopshteve. Kjo reformë pritet të sjellë përmirësim në cilësinë e arsimit parashkollor në vendin tonë. Kostoja e reformës është 327 milionë lekë dhe do të vazhdojë të mbulohet nga transferta e pakushtëzuar e vitit 2024.

Pjesa Sektoriale e Transfertës së Pakushtëzuar përfshin financimin për funksionet e reja të



transferuara në nivel vendor në vitin 2016, sipas ligjit nr. 139, datë 17.12.2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”. Fondet për këto funksione nuk ndahen sipas formulës së ndarjes së transfertës së pakushtëzuar të përcaktuar në nenin 24, të ligjit nr. 68, datë 27.4.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”. Fondet për këto funksione ndahen për çdo funksion dhe për çdo bashki, sipas kriterëve specifike të përcaktuara në Aneksin nr. 4 dhe në kolonat e veçanta në tabelën nr. 3, pjesë përbërëse të ligjit vjetor të buxhetit të vitit 2024.

Buxheti i vitit 2024, vijon vazhdimin e reformës në arsimin parashkollor. Duke filluar nga viti 2019, dhe në buxhetin e vitit 2024, fondet për arsimin parashkollor ndahen kryesisht mbi bazën e numrit të fëmijëve me moshë 3–6 vjeç, si treguesi më i mirë i nevojës për shërbim dhe pjesërisht bazohet në sistemin aktual të ndarjes së fondeve sipas numrit të edukatoreve të transferuara në vitin 2016 deri në 2018. Më specifikisht, 60% e fondeve për pagat e edukatoreve ndahen mbi bazën e numrit të fëmijëve të regjistruar në kopshte dhe 40% mbi bazën e numrit të edukatoreve pranë këtyre kopshteve. Kjo reformë siguron një ndarje më të mirë të fondeve, duke u bazuar në numrin e fëmijëve që duhet t’u ofrohet edukimi parashkollor. Reforma është në përputhje me parashikimet e nenit 28 dhe 37, të ligjit nr. 69, datë 21.6.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar” dhe praktikën e mira ndërkombëtare që rekomandojnë një ndarje të fondeve, kryesisht mbi bazën e numrit të fëmijëve. Ndryshimi i sistemit të ndarjes së fondeve për arsimin parashkollor në vendin tonë përbën një domosdoshmëri, pasi para kësaj reforme nuk reflektoheshin në mënyrë të saktë ndryshimet sociale, demografike dhe infrastrukturore që kanë ndodhur përgjatë më shumë se dy dekadave të fundit. Kjo domosdoshmëri njihet edhe nga legjislacioni aktual për arsimin parauniversitar në Shqipëri, i cili sugjeron një ndarje të fondeve, kryesisht mbi bazën e numrit të fëmijëve.

Kjo reformë siguron:

- Uljen e madhësisë mesatare të grupeve/klasave të fëmijëve në kopshte nga raporti mesatar 18 fëmijë për një edukatore (para reformës) në raportin 15 fëmijë për një edukatore;

- Shtimin e fondeve në ato bashki ku ka një nevojë reale për shtimin e numrit të edukatoreve duke ulur madhësinë maksimale të grupeve nga 26 apo 25 fëmijë për një edukatore (para reformës) në 18 fëmijë për edukatore, një parakusht për përmirësimin e cilësisë së edukimit për fëmijët nga 3–6 vjeç që ndjekin kopshtet publike;

- Ruajtjen e fondeve aktuale për ato bashki të cilat rezultojnë të kenë një numër relativisht “të lartë” edukatorësh për numrin e fëmijëve të regjistruar në kopshte, krahasimisht me bashkitë e tjera;

- Një ndarje më të drejtë të fondeve për pagat e edukatoreve, duke zbutur diferencat ndërmjet bashkive për sa i përket raportit fëmijë për edukatore;

- Shtim fondi për stafin mbështetës të arsimit parashkollor.

Kjo reformë, bën një ndarje më të drejtë të fondeve ndërmjet bashkive, zbut diferencat ndërmjet bashkive për sa i përket raportit “fëmijë për edukatore” dhe siguron fonde shtesë për ato bashki që kanë një nevojë imediate për rritjen e numrit të edukatorëve.

Në buxhetin e vitit 2024, do të ndahen me formulë 27,857,682,600 lekë e cila përfshin edhe 4,803,902,000 lekë për personelin mësimor në arsimin parashkollor që i përketin transfertës së pakushtëzuar sektoriale. Fondet e nevojshme për ushtrimin e funksioneve të reja të transferuara në vitin 2016, paraqiten në tabelën nr. 3, pjesë përbërëse e ligjit vjetor të buxhetit të vitit 2024.

3. Ndarja e Transfertës së Pakushtëzuar të përgjithshme ndërmjet dy niveleve të Qeverisjes Vendore

Për vitin 2024, për financimin e funksioneve të veta Bashkitë marrin 96.8% të totalit të transfertës së pakushtëzuar të përgjithshme për t’u ndarë me formulë, ose **22,006,780,600 lekë**.

Funksionet e transferuara te bashkitë në vitin 2016, financohen nëpërmjet transfertave të pakushtëzuara sektoriale me kolona të veçanta në tabelën nr.3 pjesë përbërëse e ligjit vjetor të buxhetit të vitit 2024. Fondet për arsimin parashkollor në këtë buxhet janë shpërndarë sipas një formule e cila mbështetet kryesisht në numrin e fëmijëve me moshë 3–6 vjeç.



Ndarja e transfertës së pakushtëzuar të përgjithshme ndërmjet dy niveleve të qeverisjes	Në përqindje	Vlera në lekë
Transferta e pakushtëzuar për bashkitë	96.8%	22,006,780,600
Transferta e pakushtëzuar për qarqet	3.2%	720,000,000

4. Koeficienti i përshtatjes së të dhënave të popullsisë

Popullsia është një tregues i lidhur ngushtë me shpenzimet dhe nevojat për shërbime. Për rrjedhojë popullsia do të vazhdojë të mbetet kriteri kryesor për ndarjen e transfertës së pakushtëzuar ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore.

Koeficienti i përshtatjes së të dhënave të popullsisë	30%
Banorë rezidentë efektivë = $[\text{Census} + (\text{Regjistri i gjendjes civile} - \text{Census}) * 30\%]$	3,335,940

Të dhënat për popullsinë që përdoren në aplikimin e formulës bazohen kryesisht në të dhënat e Censurit të vitit 2011. Këtyre të dhënave u shtohet 30% e diferencës midis të dhënave të Censurit dhe Gjendjes Civile (të vitit 2023) për secilën njësi të vetëqeverisjes vendore. Kështu, nëse një njësi e vetëqeverisjes vendore sipas Census-it të vitit 2011 ka 30,000 banorë, ndërsa sipas Regjistrit të Gjendjes Civile rezulton të ketë 45,000 banorë, atëherë, numri i popullsisë së përdorur për alokimin e fondeve për këtë bashki do të jetë $30,000 + [(45,000 - 30,000) * 30\%] = 34,500$ banorë të konsideruar rezidentë efektivë në atë njësi të vetëqeverisjes vendore. Në këtë mënyrë, popullsia rezidente rezulton rreth 3.3 milionë banorë, nga 2.8 milionë që raportohet nga Censusi dhe 4.6 milionë që raportohet nga Regjistri i Gjendjes Civile. Vlerësohet se një kompromis midis dy burimeve të të dhënave është i nevojshëm dhe rregullimi me 30% të diferencës midis të dhënave të Gjendjes Civile dhe Censurit amortizon ndryshimet në transfertë që do të pësonte një njësi nga kalimi nga një formulë në tjetrën.

5. Shpërndarja e transfertës së pakushtëzuar të përgjithshme për Bashkitë

Për vitin 2024, transfertat e pakushtëzuar e cila ndahet sipas formulës për 61 bashkitë është 22,006,780,600 lekë dhe do të ndahet sipas kriterëve të mëposhtme. Kriteret e shpërndarjes së fondeve në formulë kërkojnë të identifikojnë nevojat reale të shpenzimeve të njësive të ndryshme të vetëqeverisjes vendore mbi bazën e popullsisë, dendësisë së popullsisë dhe numrit të fëmijëve në kopshte dhe nxënësve në shkollat publike 9-vjeçare dhe të mesme në territorin e një bashkie.

Në formulë, 80% e transfertës së përgjithshme për bashkitë alokohet mbi bazën e popullsisë relative. Në vijim të rregullimit të numrit të popullsisë së Censurit duke i shtuar atij edhe 30% të diferencës midis të dhënave të Gjendjes Civile dhe të dhënave të Censurit, çdo njësi e vetëqeverisjes vendore merr një transfertë të pakushtëzuar prej 5,278 lekë, për çdo banor rezident në njësinë e vetëqeverisjes vendore.

Përbërja e transfertës së pakushtëzuar të përgjithshme për bashkitë	22,006,780,600
Komponenti I: Ndarja sipas popullsisë (në përqindje)	80%
Transferta e pakushtëzuar që shpërndahet sipas numrit të banorëve rezidentë efektivë	17,605,424,480
Transferta e pakushtëzuar për frymë	5,278

Dendësia e popullsisë është një kriter tjetër që përdoret për shpërndarjen e transfertës së pakushtëzuar për bashkitë. Dendësia e popullsisë më e ulët është në bashkitë që përbëhen kryesisht ose plotësisht nga zona rurale dhe/ose malore. Ka një korrelacion të fortë mes njësive të vetëqeverisjes vendore me dendësi të ulët dhe atyre sipërfaqja e të cilave është mbi 50% malore. Kështu koeficienti, “dendësi e ulët e popullsisë”, çon fonde shtesë në të njëjtin drejtim siç bënte formula e mëparshme e ndarjes së transfertës së pakushtëzuar, nëpërmjet përdorimit të koeficientëve shtesë për njësitë vendore malore dhe në vështirësi financiare.

Në formulë 15 % e totalit të transfertës së pakushtëzuar të përgjithshme për bashkitë, ndahet mbi bazën e dendësisë së popullsisë, e cila ndahet në kufij sipas tabelës së mëposhtme.



Komponenti II: Ndarja sipas dendësisë së popullsisë (në përqindje)							15%
Madhësia e transfertës së pakushtëzuar që shpërndahet sipas dendësisë së popullsisë							3,301,017,090
Mesatarja Kombëtare e Dendësisë së Popullsisë							118 banorë/km ²
Transferta për frymë nga densiteti i popullsisë							2,698 lek/banorë
Kufijtë e dendësisë së popullsisë si përqindje ndaj mesatares kombëtare	Koeficientët e rregullimit	Numri i NJVQV-ve përfituese	Dendësia e popullsisë korresponduese	Popullsia në çdo grup	Popullsia e korrigjuar me koeficientin e rregullimit për çdo grup	Shuma e fondeve shtesë për çdo grup	
Kufiri 1	22%	2.270	12	25.3	132,759	301,363	813,116,552
Kufiri 2	43%	1.669	11	50.5	259,546	433,181	1,168,780,990
Kufiri 3	75%	0.900	10	88.2	347,063	312,357	842,780,786
Kufiri 4	110%	0.350	6	129.3	286,615	100,315	270,663,947
Kufiri 5	>110%	0.033	22	>130.1	2,309,957	76,229	205,674,815
Totali			61		3,335,940	1,223,445	3,301,017,090

Një njësi e vetëqeverisjes vendore me një sipërfaqe të madhe dhe një popullsi më të ulët, nënkupton, për të gjitha kushtet e tjera të barabarta, të ketë kosto më të larta të ofrimit të shërbimeve, rrugë më të gjata dhe shpenzime të tjera infrastrukturore që kushtojnë. Për të kompensuar njësitë me dendësi më të ulët për kostot më të larta të shërbimit janë krijuar 5 grupime të njësive të vetëqeverisjes vendore sipas ngjashmërisë më të madhe të dendësisë. Njësitë me dendësi më të ulët popullsie përfitojnë nga koeficientë shtesë më të lartë se ato njësi të cilat kanë një afërsi më të madhe të dendësisë me mesataren kombëtare. Nga ky kriter përfitojnë të gjitha bashkitë, në të cilat banojnë 3,335,940 banorë rezidentë efektivë. Nëse një njësi e vetëqeverisjes vendore ka një dendësi mesatare nën 22% të mesatares kombëtare, ose mesatarisht 26 banorë për km², atëherë popullsia e saj relative do të shumëzohet me 2.270. Nëse ka një dendësi midis 22% dhe 44% të mesatares kombëtare, atëherë popullsia e saj relative do të shumëzohet me një koeficient prej 1.669. Pra duke u afruar mesatares kombëtare, koeficientët vijnë duke u zvogëluar. Në përfundim numri i popullsisë për çdo grup dendësie, shumëzohet me koeficientin përkatës dhe transfertën për frymë prej **2,698 lekë** për banorë (që rezulton nga pjesëtimi i shumës prej **3,301,017,090 lekë** me popullsinë totale që rezulton nga aplikimi i koeficientëve për çdo grup).

Pjesa prej 5% e totalit të transfertës së pakushtëzuar të përgjithshme për bashkitë, ose 1,100,339,030 lekë do të ndahet mbi numrin faktik të nxënësve në shkollat publike në çdo bashki, kundrejt totalit kombëtar të nxënësve. Bashkitë do të marrin një fond prej 3,120 lekë për çdo nxënës në territorin e tyre.

Komponenti III: Ndarja sipas numrit të nxënësve (në %)	5%
Transferta e pakushtëzuar sipas numrit të nxënësve, në lek	1,100,339,030
Transferta për një nxënës	3,120 lek/nxënës

6. Shpërndarja e transfertës së pakushtëzuar sektoriale për Bashkitë

Nga viti 2019, dhe në vazhdim transfertat e pakushtëzuar sektoriale për arsimin parashkollor ndahet me një formulë. Sipas kësaj formule, 60% e shumës së transfertës së pakushtëzuar sektoriale për arsimin parashkollor ndahet mbi bazën e numrit të fëmijëve të regjistruar në kopshte dhe 40% mbi bazën e numrit të edukatoreve pranë këtyre kopshteve. Për vitin 2024 me këtë formulë shpërndahen 4,803,902,000 lekë si transfertë e pakushtëzuar sektoriale për arsimin parashkollor.

7. Ekualizimi i transfertës së pakushtëzuar mbi bazën e të ardhurave nga taksat e ndara dhe në raport me transfertën e vitit të mëparshëm

Për të siguruar një ekualizim horizontal efektiv të transfertës së pakushtëzuar ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore në mënyrë që të merren në konsideratë kapacitetet e ndryshme fiskale ndërmjet tyre, në formulë llogaritjet bazohen mbi të ardhurat faktike nga taksat e ndara ndërmjet qeverisë qendrore dhe asaj vendore, të cilat mbledhen dhe u transferohen plotësisht ose pjesërisht bashkive nga administrata qendrore. Ekualizimi fiskal bazohet në të ardhurat faktike nga tatimi mbi të ardhurat personale, nga taksa vjetore e automjeteve të përdorura dhe taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme



të cilat mblidhen nga agjenci qendrore dhe u transferohen njësisë të vetëqeverisjes vendore. Në këtë mënyrë njësitë e vetëqeverisjes vendore sigurohen që të ardhurat që ata mbledhin vetë nuk preken nga sistemi i ekualizimit duke evituar kështu çdo lloj disincitivimi në mbledhjen e taksave. Në vitin 2022, pjesa e të ardhurave nga këto taksa që u janë transferuar njësisë të vetëqeverisjes vendore është 3,469,288,083 lekë, dhe të ardhurat kombëtare për frymë (TAKPF), ose mesatarja kombëtare për frymë rezulton 1,040 lekë për banor, sipas konceptit “banor rezident efektiv”.

Komponenti IV: Sistemi i ekualizimit të të ardhurave						
Të ardhurat nga taksat e ndara që do të përdoren për ekualizimin e të ardhurave (TAP + taksa e automjeteve + taksa mbi transferimin e pasurisë nga personat juridik)						3,469,288,083
Të ardhurat kombëtare për frymë (TAKPF), Të ardhura për frymë (TAPF)						1,040
Nëse NJVV-të kanë TAPF nën	90%	të TAKPF, atëherë ato kompensohen me	120%	të diferencës	Madhësia e ekualizimit fiskal (fondet që duhet të shtohen)	374,691,441
duke u marrë NJVQV-ve me të ardhura për frymë mbi	120%	të mesatares kombëtare (TAKPF)	64%	të diferencës	Fondet që efektivisht shkurtohen	376,410,473
Koeficienti i rishpërndarjes						1.00

Njësitë e vetëqeverisjes vendore që kanë të ardhura për frymë (TAPF) nën 90% të mesatares kombëtare (TAKPF) prej 1,040 lekë/frymë, do të kompensohen me 120% të diferencës ndërmjet të ardhurave të tyre për frymë dhe mesatares kombëtare. Kjo llogaritje tregon sa fonde do duhej t'u shtoheshin njësisë me të ardhura më të ulëta për t'i sjellë ato në nivelin prej 936 lekë/frymë (ku $1,040 \times 90\% = 936$ lekë). Për të sjellë të gjitha bashkitë me të ardhura më “të ulëta” në nivelin prej 90% të mesatares kombëtare, njësisë me të ardhura më të larta se 120% e mesatares kombëtare, (pra me TAPF mbi 1,248 lekë/frymë) do t'u merret 64% e diferencës midis të ardhurave të tyre për frymë dhe 120% të mesatares kombëtare. P.sh., nëse një njësi e vetëqeverisjes vendore ka të ardhura për frymë prej 1600 lekë/frymë, sipas formulës së mësipërme asaj do t'i zbriten 225 lekë/frymë $[1600 - (120\% \times 1,040)] \times 64\% = 225$ lekë/banor. Kjo llogaritje në fund tregon sa janë fondet realisht të disponueshme të cilat mund të transferohen nga njësitë me të ardhura më të larta tek ato më të ulëta. Sistemi balancohet automatikisht nëpërmjet një koeficienti të rishpërndarjes i cili përcaktohet nga raporti midis fondeve disponibël për ekualizim dhe fondeve të nevojshme për ekualizim. Për vitin 2024, fondet e nevojshme për ekualizim janë 374,691,441 lekë, ndërkohë që fondet e disponueshme për ekualizim që vijnë nga “taksimi” prej 64% të të ardhurave mbi 1,248 lekë/frymë i njësisë me të ardhura më të larta janë 376,410,473 lekë dhe për rrjedhojë koeficienti i rishpërndarjes është 1.00.

8. Shpërndarja e transfertës së pakushtëzuar për Qarqet

Qarqeve do t'u ndahen 720 milionë lekë, sipas një shume fikse, të barabartë për secilin nga 12 Qarqet, sipas popullsisë rezidente dhe sipas dendësisë së popullsisë në çdo qark kundrejt mesatares kombëtare. Sipas kriterit të parë, 20% e totalit të transfertës së pakushtëzuar të qarqeve (ose 144 milionë lekë) do të shpërndahet si një shumë fikse prej rreth 12 milionë lekë për secilin nga 12 Qarqet.

Përbërja e transfertës së pakushtëzuar për qarqet	720,000,000
Komponenti I: Shuma fikse për qarqet (në përqindje)	20%
Transferta e pakushtëzuar për t'u ndarë sipas shumës fikse	144,000,000
Shuma fikse e transfertës së pakushtëzuar për çdo qark	12,000,000



Sipas kriterit të dytë, 50% e transfertës së pakushtëzuar (ose 360 milionë lekë) do të ndahet përpjesëtimisht sipas popullsisë rezidente në çdo qark, kundrejt popullsisë totale. Të dhënat për popullsinë e qarqeve ndjekin të njëjtin rregullim të bërë për popullsinë e bashkive.

Komponenti II: Ndarja sipas banorëve rezidentë efektivë (në përqindje)	50%
Transferta e pakushtëzuar që shpërndahet sipas numrit të banorëve rezidentë efektivë	360,000,000
Transferta e pakushtëzuar për frymë (banorë rezidentë efektivë)	108

Sipas kriterit të tretë, 30% e transfertës së pakushtëzuar (ose 216 milionë lekë) do të ndahen mbi bazën e dendësisë së popullsisë në çdo qark, kundrejt dendësisë mesatare kombëtare.

Komponenti III: Ndarja sipas dendësisë së popullsisë (në përqindje)							30%
Transferta e pakushtëzuar që shpërndahet sipas dendësisë së popullsisë							216,000,000
Mesatarja kombëtare e dendësisë së popullsisë							118 banorë/km ²
Transferta për frymë nga komponenti i dendësisë së popullsisë							273 lek/banorë
Kufijtë e dendësisë së popullsisë si përqindje ndaj mesatares kombëtare	Koeficientët	Numri i qarqeve që përfitojnë	Dendësia e popullsisë për grup	Popullsia për çdo grup	Shuma e shtuar për secilin grup	% e shpërndarjes për grup	
Kufiri 1 90%	0,3	4	105.8	910,909	74,661,796	35%	
Kufiri 2 65%	0,5	3	76.4	660,407	90,216,124	42%	
Kufiri 3 35%	1,0	2	41.1	187,114	51,122,080	24%	
Totali		9		1,758,430	216,000,000		

Qarqet me dendësi më të ulët të popullsisë, duke prezumuar kosto më të larta për ofrimin e shërbimeve dhe/ose kapacitet fiskal më të ulët, do të përfitojnë fonde shtesë nëpërmjet koeficientëve të përcaktuar më sipër për secilin nga tre grupet. Qarqet janë ndarë në tre grupe të ndryshëm sipas raportit mes dendësisë së tyre të popullsisë dhe mesatares kombëtare. Kufijtë e ndarjes së grupeve ndjekin ngjashmërinë e raportit të dendësisë ndaj mesatares kombëtare. Kështu, nëse një Qark ka një dendësi të popullsisë nën 35% të mesatares kombëtare, që nënkupton mesatarisht më pak se 41 banorë për km², kundrejt mesatares kombëtare prej 118 banorë për km², dhe një popullsi prej 93,225 banorësh rezidentë, atëherë popullsia e atij qarku shumëzohet me koeficientin shtesë përkatës (+1) dhe transfertën për frymë prej 266 lekë për banor, duke rezultuar në një shtesë fondesh prej 25,450,425 lekë (i llogaritur në këtë mënyrë: 93,225*1*273).

ANEKS 2 KRITERET E SHPËRNDARJES SË FONDIT REZERVË

Nivelet e pushtetit vendor	Kriteret
A. Për bashkitë	- Kompensim për ndonjë gabim në përlogaritjen e kriterëve të formulës së shpërndarjes së transfertës së pakushtëzuar për vitin 2024; - Për funksionet e reja të transferuara në bashkitë që nga viti 2016; - Për nevoja të ndryshme financiare të bashkive.
B. Për qarqet	Për shpenzime të ndryshme që mund të nevojiten gjatë vitit.

Shuma që akordohet nga fondi rezervë për njësitë e vetëqeverisjes vendore nuk duhet të kalojë 50 për qind të nivelit të transfertës së pakushtëzuar të akorduar me ligjin e buxhetit të vitit 2024.

Pjesa e papërdorur e fondit rezervë në vitin buxhetor 2024, kalon në transfertën e pakushtëzuar të vitit 2025.

Procedurat për alokimin e këtij fondi përcaktohen në udhëzimin plotësues të zbatimit të buxhetit të vitit 2024.



ANEKSI 3
PROGRAMI BUXHETOR PËR
INFRASTRUKTURËN VENDORE DHE
RAJONALE NË FONDIN SHQIPTAR
TË ZHVILLIMIT

1. Fondet për Infrastrukturën Vendore dhe Rajonale, të parashikuara si program buxhetor në Fondin Shqiptar të Zhvillimit, janë një mekanizëm financiar që mbështet politikën kombëtare të zhvillimit rajonal dhe vendor. Autoriteti programues, kontraktues dhe zbatues është Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

2. Specifikimet, rregullat, kriteret për financimin e projekteve si dhe shpërndarja e Fondit për Infrastrukturën Vendore dhe Rajonale për financimin e projekteve të reja miratohen nga Këshilli Drejtues i Fondit Shqiptar të Zhvillimit.

3. Fondi Shqiptar i Zhvillimit administron nevojat dhe propozimet nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, qendrore dhe aktorë të tjerë (përfshirë FSHZH dhe njësitë e zhvillimit rajonal të tij) që konsistojnë në projekte në interes dhe në funksion të zhvillimit lokal e rajonal, përfshirë edhe projekte zhvillimore me natyrë ekonomike, të zbatuara në partneritet midis FSHZH dhe njërive të vetëqeverisjes vendore dhe subjekte të tjera.

4. Rregulla të hollësishme lidhur me funksionimin e të gjithë procesit të programimit, monitorimit dhe raportimit të ecurisë së zbatimit miratohen me vendim të Këshillit Drejtues të Fondit Shqiptar.

5. Nga fondi për Infrastrukturën Vendore dhe Rajonale, Fondi Shqiptar i Zhvillimit me përparësi duhet të financojë projektet e investimeve në proces me burim financimi ish-Fondin e Zhvillimit të Rajoneve-Infrastruktura Vendore dhe Rajonale. Pjesa e financimit të projekteve në proces vendoset në listën e investimeve të FSHZH-së, në përputhje me ecurinë e projektit. Fondi Shqiptar i Zhvillimit mund të kërkojë rialokime midis projekteve, sipas procedurave të miratuara për investimet publike.

6. Fondi Shqiptar i Zhvillimit, brenda vitit 2024, përmbyll procesin e financimit të projekteve të pa financuara nga ish-Fondi i Zhvillimit të Rajoneve (Infrastruktura Vendore dhe Rajonale). Për këtë ai rakordon me të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe financon ato projekte që kanë dokumentacion të rregullt ligjor. Të gjitha projektet e tjera që nuk përmbushin kriteret ligjore u kthehen

njërive të vetëqeverisjes vendore, duke argumentuar arsyet e kthimit të tyre.

ANEKS 4
PËR FUNKSIONET E TRANSFERUARA NË
NJËSITË E VETËQEVERISJES VENDORE

1. Konviktet e arsimit parauniversitar

Në transfertën e vitit 2024, disa bashkive u janë akorduar fondet për konviktet e arsimit parauniversitar. Në këtë transfertë përfshihen fondet për shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore të personelit (punonjës dhe edukator), për shpenzimet operative dhe për shpenzimet për investime.

Për llogaritjen dhe kryerjen e pagesave të pagave dhe sigurimeve shoqërore të personelit të këtyre konvikteve, njësitë e vetëqeverisjes vendore do të mbështeten në kuadrin rregullator që ka përdorur Ministria e Arsimit dhe Sportit.

Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit në këtë sektor.

2. Qendrat e shërbimeve sociale

Në transfertën e vitit 2024 të bashkive, Berat, Elbasan, Shkodër, Vau i Dejës, Fier, Kuçovë dhe Kukës janë akorduar fondet për paga dhe sigurime shoqërore për personelin shërbyes dhe shpenzime operative për qendrat, “Lira”, Berat, “Balash”, Elbasan, “Shpresa” Shkodër, “Opera Della Madonnina Della Grappa”, Shkodër, “Besa” Vau i Dejës, “Horizont”, Fier dhe qendrat ditore të fëmijëve me Aftësi të Kufizuara për bashkitë Kuçovë dhe Kukës.

Për llogaritjen dhe kryerjen e pagesave të pagave dhe sigurimeve shoqërore të personelit të këtyre qendrave bashkitë Berat, Elbasan, Shkodër, Vau i Dejës, Fier, Kuçovë, dhe Kukës do të mbështeten në kuadrin rregullator që përdor Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit në këto qendra.



3. Shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi (MZSH)

Në transfertën e vitit 2024 të bashkive, është akorduar fondi për funksionin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi. Ministria e Brendshme duhet t'u dërgojë bashkive kuadrin ligjor dhe të dhëna të tjera që disponon të cilat janë të lidhura me shërbimin. Në tabelën nr. 3, të ligjit vjetor të buxhetit, është pasqyruar edhe efekti i rritjes së pagave për këtë funksion për vitin 2024, në zbatim të vendimit nr. 240, datë 20.4.2023, "Për një ndryshim në vendimin nr. 350, datë 19.4.2017, të Këshillit të Ministrave, 'Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin'", të ndryshuar.

Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit në këtë sektor.

4. Personeli mësimor dhe jomësimor në arsimin parashkollor dhe personeli jomësimor në arsimin parauniversitar

Në transfertën e vitit 2024, njërive të vetëqeverisjes vendore u janë akorduar fondet për personelin edukativ dhe ndihmës të arsimit parashkollor si dhe fondet për personelin ndihmës të arsimit parauniversitar. Në fondet e personelit ndihmës të arsimit parauniversitar nuk përfshihet arsimi i mesëm profesional. Në tabelën nr. 3, të ligjit vjetor të buxhetit, është pasqyruar edhe efekti i rritjes së pagave për këtë funksion për vitin 2024, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 241, datë 20.4.2023, "Për disa ndryshime në vendimin nr. 175, datë 8.3.2017, të Këshillit të Ministrave, 'Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë, në arsimin parauniversitar'", të ndryshuar.

Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit në këtë sektor.

5. Rugët rurale

Në transfertën e vitit 2024, njërive të vetëqeverisjes vendore u është akorduar fondi për rrugët rurale të transferuara nga qarku në bashki. Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor

në fuqi. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit në rrugët rurale.

6. Administrimi i pyjeve

Në transfertën e vitit 2024, njërive të vetëqeverisjes vendore u është akorduar fondi për Shërbimin Pyjor. Në tabelën nr. 3, të ligjit vjetor të buxhetit, është pasqyruar edhe efekti i rritjes së pagave për këtë funksion për vitin 2024, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 242, datë 20.4.2023, "Për disa ndryshime në vendimin nr. 234, datë 20.4.2022, të Këshillit të Ministrave, 'Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike'", të ndryshuar.

Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit në këtë sektor.

7. Ujitja dhe Kullimi

Në transfertën e vitit 2024, njërive të vetëqeverisjes vendore u është akorduar fondi për ujitjen dhe kullimin. Në tabelën nr. 3, të ligjit vjetor të buxhetit, është pasqyruar edhe efekti i rritjes së pagave për këtë funksion për vitin 2024, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 242, datë 20.4.2023, "Për disa ndryshime në vendimin nr. 234, datë 20.4.2022, të Këshillit të Ministrave, 'Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike'", të ndryshuar.

Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit në këtë sektor.

8. Klubet sportive shumësportëshe , "Partizani" dhe "Studenti"

Në transfertën e vitit 2024, bashkisë Tiranë i janë akorduar fondet për shpenzime për personelin dhe për shpenzime operative për klubet sportive shumësportëshe "Partizani" dhe "Studenti". Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Bashkia Tiranë mund të shtojë fonde nga të ardhurat e veta për të rritur cilësinë e shërbimit në këto klube.



ANEKS NR. 5
PËR PUNONJËSIT ME KONTRATË TË
PËRKOHSHME

Për kontraktimin e punonjësve me kohë të pjesshme mbi numrin organik të punonjësve të institucioneve buxhetore për vitin 2024, ndiqen këto rregulla:

1. Numri i punonjësve me kontratë të përkohshme miratohet nga Këshilli i Ministrave nëpërmjet propozimit të ministrit përgjegjës për financat.

2. Institucioni duhet të ketë fondet e nevojshme për mbulimin e shpenzimeve të personelit të kontraktuar.

3. Veprimtaria që kryejnë punonjësit me kontratë është kryesisht veprimtari e njësive strukturore mbështetëse/rregullatore/shërbimi të institucionit dhe në asnjë rast veprimtari inspektuese apo audituese.

4. Kontraktimi i punonjësve bëhet në përputhje me kriteret e parashikuara për atë pozicion pune, për një periudhë kohore deri në 6 muaj gjatë një viti buxhetor me kohë pune ditore të plotë, ose deri në 6 orë në ditë përgjatë vitit buxhetor. Përfshirje nga ky përcaktim, bën kontraktimi i punonjësve që kryejnë një veprimtari që realizon të ardhura dytësore, përdorimi i të cilave parashikohet në ligjin vjetor të buxhetit, për këtë qëllim.

5. Pagesa e punonjësve me kontratë të përkohshme, përcaktohet në referencë të vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave, për pozicionin për të cilin ai kontraktohet. Për pozicionin “Specialist”, paga e punonjësit me kontratë të përkohshme në institucionet e pavarura dhe aparatet e ministrive nuk kalon nivelin e kategorisë IV-2 dhe në institucionet në varësi të tyre, nivelin e kategorisë IV-3. Në rast se pozicioni ka shtesa specifike mbi pagën e kategorisë/klasës përkatëse, ato nuk përfitohen nga punonjësi me kontratë të përkohshme, me përjashtim të shtesës mbi pagë për punë të vështira e të dëmshme për shëndetin.

6. Rregullat përjashtimore për punonjësit me kontratë të përkohshme të Kryeministrit, përcaktohen në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave.

7. Pagesa bëhet në përputhje me procedurat e kryerjes së pagesave për punonjësit organik dhe përfshihet në shpenzimet e personelit të institucionit. Përfshirje nga ky rregull, bëjnë anketuesit/kontrollorët e terrenit të kontraktuar në

realizimin e Censurit dhe anketimeve afatshkurta (më pak se dy javë), si dhe operatorët teknik për përdorimin e pajisjeve të teknologjisë së informacionit në qendrat e votimit, pagesa e të cilëve e bazuar në ditët e punës, do të përfshihet në shpenzimet operative të institucionit.

8. Në raste specifike që lidhen me mësimdhënien, veprimtarinë bujqësore, veprimtarinë statistikore, rregullat dhe procedurat e marrjes në punë të punonjësve me kontratë përcaktohen nëpërmjet udhëzimit të përbashkët të miratuar mes institucionit qendror përgjegjës dhe ministrisë përgjegjëse për financat.

ANEKSI 6
FONDI PËR PARANDALIMIN DHE
MENAXHIMIN E FATKEQËSIVE
NATYRORE

1. Fondi për **Parandalimin dhe Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore** është një mekanizëm financiar që mbështet politikën kombëtare të parandalimit dhe menaxhimit rajonal dhe vendor të fatkeqësive natyrore e të tjera.

2. Për vitin 2024, Fondi për Parandalimin dhe Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore është pjesë e fondit të akorduar në buxhetin e vitit 2024 në programin “Emergjencat Civile”, në Ministrinë e Mbrojtjes.

3. Vlerësimi i projekteve sipas njësive të vetëqeverisjes vendore aplikuese bëhet me vendim të Komisionit për Parandalimin dhe Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore, i cili kryesohet nga drejtori i AKMC - Kryetar dhe ka në përbërje anëtarë nga struktura përgjegjëse për mbrojtjen civile (Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile), anëtarë nga Ministria e Mbrojtjes, anëtar nga ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor, dhe anëtarë nga Shoqata për Autonomi Vendore.

4. Komisioni për Parandalimin dhe Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore miraton; specifikimet, rregullat dhe kriteret **për financimin e projekteve në infrastrukturë dhe për blerje pajisjesh për Parandalimin dhe Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore** si dhe vlerësimin e projekteve.

5. Sekretariati teknik për Fondin e Parandalimit dhe Menaxhimit të Fatkeqësive Natyrore ngrihet pranë AKMC-së dhe ndihmon punën e Komisionit



për Parandalimin dhe Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore.

6. Fondi i Parandalimit dhe Menaxhimit të Fatkeqësive Natyrore me përparësi duhet të financojë projektet e investimeve në proces. Pjesa e financimit të projekteve në proces vendoset në listën e investimeve të Ministrisë së Mbrojtjes, në përputhje me ecurinë e projektit. Ministria e Mbrojtjes mund të kërkojë rialokime midis projekteve të Fondit të Parandalimit dhe Menaxhimit të Fatkeqësive Natyrore, sipas procedurave të miratuara për investimet publike.

7. Thirrjet për aplikim në Fondin Parandalimit dhe Menaxhimin të Fatkeqësive Natyrore për vitin buxhetor 2024, mund të bëhen që në nëntor të vitit paraardhës deri në 31 janar të vitit korrent.

8. Projektet e përzgjedhura nga Komisioni për Parandalimin dhe Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore, nëpërmjet Ministrisë së Mbrojtjes dërgohen për miratim pranë Këshillit të Ministrave brenda datës 15 Shkurt të vitit korrent.

9. Këshilli i Ministrave miraton projektet fituese, si dhe autoritetin kontraktor për zbatimin e projekteve sipas njësive të vetëqeverisjes vendore brenda datës 28 Shkurt të vitit korrent.

10. Fondi i Parandalimit dhe Menaxhimit të Fatkeqësive Natyrore nuk trashëgohet në vitin e ardhshëm, buxhetor.

11. Subjektet aplikuese dhe zbatuese janë njësitë e vetëqeverisjes vendore.

ANEKSI 7 FONDI PËR DIGAT

1. **Fondi për Digat** është një mekanizëm financiar që mbështet **rehabilitimin/ rikonstrukcionin e digave të rezervuarëve**, duke mbështetur politikën kombëtare të parandalimit dhe menaxhimit të fatkeqësive natyrore.

2. Për vitin 2024, Fondi për Digat është pjesë e fondit të akorduar në buxhetin e vitit 2024 në programin “Emergjencat Civile”, në Ministrinë e Mbrojtjes.

3. Vlerësimi i projekteve që përfshin, studimin dhe projektin e zbatimit sipas njësive të vetëqeverisjes vendore aplikuese bëhet me vendim të Komisionit për Parandalimin dhe Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore.

4. Komisioni për Parandalimin dhe Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore kryesohet nga Drejtori i

AKMC - Kryetar dhe ka në përbërje anëtarë nga struktura përgjegjëse për mbrojtjen civile (Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile), anëtarë nga Ministria e Mbrojtjes, anëtarë nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, anëtar nga ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor, anëtarë nga Shoqata për Autonomi Vendore, dhe bashkëpunon edhe me Komitetin Kombëtar të Digave të Mëdha.

5. Komisioni për Parandalimin dhe Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore miraton specifikimet, rregullat dhe kriteret **për financimin e projekteve për rehabilitimin dhe rikonstrukcionin e digave të rezervuarëve** si dhe vlerësimin e projekteve.

6. Sekretariati teknik për Fondin për Digat ngrihet pranë AKMC-së dhe ndihmon punën e Komisionit për Parandalimin dhe Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore.

7. Projektet që përfitojnë financimin vendosen në listën e investimeve të Ministrisë së Mbrojtjes dhe në përputhje me ecurinë e tyre, Ministria e Mbrojtjes mund të kërkojë rialokime mes projekteve të Fondit për Digat sipas procedurave të miratuara për investimet publike.

8. Thirrjet për aplikim në Fondin për Digat për vitin buxhetor 2024, fillojnë nga nëntori 2023 dhe deri në 28 shkurt 2024.

9. Projektet e përzgjedhura nga Komisioni për Parandalimin dhe Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore, nëpërmjet Ministrisë së Mbrojtjes dërgohen për miratim pranë Këshillit të Ministrave brenda datës 15 mars 2024.

10. Këshilli i Ministrave miraton projektet fituese, si dhe autoritetin kontraktor për zbatimin e projekteve sipas njësive të vetëqeverisjes vendore brenda datës 1 prill 2024.

11. Fondi për Digat nuk trashëgohet në vitin e ardhshëm, buxhetor.

12. Subjektet aplikuese dhe zbatuese janë njësitë e vetëqeverisjes vendore.



ANEKSI 8
PËR MENAXHIMIN E MBETJEVE
URBANE NË NJËSITË E
VETËQEVERISJES VENDORE

1. Fondet shtesë për menaxhimin e mbetjeve urbane akordohen si transfertë e pakushtëzuar sektoriale sipas tabelës nr. 3 “Transferta e pakushtëzuar për bashkitë për vitin 2024”. Këto fonde janë një mekanizëm financiar shtesë që mbështet bashkitë për mirëmenaxhimin e mbetjeve urbane.

2. Detajimi i këtyre fondeve në tabelën nr. 3 “Transferta e pakushtëzuar për bashkitë për vitin 2024”, sipas bashkive është bërë duke marrë parasysh: a) sasinë e mbetjeve vjetore dhe b) kostot shtesë për transportin e tyre në pikat fundore të grumbullimit dhe përpunimit.

3. Detajimi i fondeve është bërë për bashkitë:

a) Malësi e Madhe, Shkodër, Vau i Dejës, Pukë, Fushë Arrëz, Lezhë dhe Kurbin për financimin e transportit të mbetjeve urbane në zonën e menaxhimit të mbetjeve Shkodër;

b) Krujë, Durrës, Vorë, Kamzë, Shijak, dhe Kavajë për financimin e transportit të mbetjeve urbane në zonën e menaxhimit të mbetjeve Tiranë;

c) Librazhd, Elbasan, Rrogozhinë, Peqin, Cërrik, Belsh, Përrenjas dhe Gramsh, për financimin e transportit të mbetjeve urbane në zonën e menaxhimit të mbetjeve Elbasan;

d) Himarë, Sarandë, Gjirokastrë, Tepelenë, Memaliaj, Këlcyrë, Përmet, Libohovë dhe Dropull, për financimin e transportit të mbetjeve urbane në zonën e menaxhimit të mbetjeve Gjirokastrë;

e) Fier, Lushnjë, Roskovec, Patos, Divjakë dhe Mallakastër, për financimin e transportit të mbetjeve urbane në zonën e menaxhimit të mbetjeve Fier.

4. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit i dërgon bashkive kuadrin ligjor, nënligjor, standardet dhe të dhëna të tjera që disponon të cilat janë të lidhura me menaxhimin e mbetjeve urbane. Njësitë e vetëqeverisjes vendore shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për transportimin e mbetjeve urbane në zonat e menaxhimit të mbetjeve.

5. Gjatë vitit 2024, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe shoqatën/përfaqësuesit e bashkive përgatit një metodologji për menaxhimin e mbetjeve urbane dhe vendos tregues performance

për bashkitë në funksion të rritjes së cilësisë së mirëmenaxhimit të mbetjeve urbane.

6. Kjo mbështetje buxhetore e cila synon mirëmenaxhimin e mbetjeve urbane duhet të bëhet pjesë e programit buxhetor afatmesëm 2024–2026 dhe në vijim e qeverisjes qendrore dhe asaj vendore. Kjo mbështetje duhet të bëhet pjesë e raportit të monitorimit të zbatimit të buxhetit të bashkive.

7. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë monitoron periodikisht përdorimin e fondit shtesë për menaxhimin e mbetjeve urbane sipas bashkive përfituese.

DEKRET

Nr. 392, datë 27.12.2023

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET

Nr. 381, datë 21.12.2023

**PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës; të neneve 13 dhe 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Embra Ibrahim Elbasani
2. Luljeta Sulejman Bila



3. Klaudio Vasil Jani
4. Livia Vasel Sokoli
5. Mirela Ibrahim Sokolaj (Krutani)
6. Jonida Hysni Mustali

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 382, datë 21.12.2023

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës; të neneve 8 dhe 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Zymryte Adem Ahmetaj (Bytyqi)
2. Latif Iso Maxharri
3. Vesa Fatmir Nishliu
4. Qendrim Fatmir Krasniqi
5. Harzije Ramazan Dushku (Ramadani)
6. Faton Xhavit Paloji
7. Florim Mehedin Sefedini

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 383, datë 21.12.2023

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, e nenit 93 të Kushtetutës; të neneve 8 dhe 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Lava Neshat Shala
2. Zara Neshat Shala

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 384, datë 21.12.2023

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, e nenit 93 të Kushtetutës; të neneve 8 dhe 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:
- Gëzim Jetullah Qarri



Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET**Nr. 385, datë 21.12.2023****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, e nenit 93 të Kushtetutës; të neneve 8, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të shtetasit:
- Arti Enis Shala

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET**Nr. 386, datë 21.12.2023****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, e nenit 93 të Kushtetutës; të neneve 8, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të shtetasit:
- Valbona Selver Muka (Shabani)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET**Nr. 387, datë 21.12.2023****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, e nenit 93 të Kushtetutës; të neneve 8, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të shtetasit:
- Manuel Bala Ukaj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

**DEKRET****Nr. 388, datë 21.12.2023****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, e nenit 93 të Kushtetutës; të neneve 8, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:**Neni 1**

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Magbule Shefshet Elshani
2. Inna Seyran Kirakosyan
3. Nuriye Nijazi Xhemaili (Djemaili)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

DEKRET**Nr. 389, datë 21.12.2023****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, e nenit 93 të Kushtetutës; të neneve 8, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:**Neni 1**

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Amir Hysen Pllana
2. Mujë Ramadan Bllaca
3. Agim Isuf Salih

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

DEKRET**Nr. 390, datë 21.12.2023****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, e nenit 93 të Kushtetutës; të nenit 16, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:**Neni 1**

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të shtetasit:

- Klajdi Albert Blea

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**



UDHËZIM

Nr. 15, datë 14.12.2023

**PËR SHËRBIMET PUBLIKE TË
TRANSPORTIT HEKURUDHOR TË
UDHËTARËVE¹**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të nenit 90, të ligjit nr. 142/2016, datë 22.12.2016, “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”,

UDHËZOJ:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi dhe objektivat

1. Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi i rregullave të shërbimeve publike të transportit hekurudhor të udhëtarëve për inkurajimin e këtij transporti dhe sigurimin e një mbrojtjeje efektive të udhëtarëve në lidhje me sa vijon:

a) mosdiskriminimit ndërmjet udhëtarëve në lidhje me kushtet e transportit dhe sigurimin e biletave;

b) përgjegjësinë e sipërmarrjeve hekurudhore dhe detyrimet e tyre të sigurimit për udhëtarët dhe bagazhet e tyre;

c) të drejtat e udhëtarëve në rast të një aksidenti që rrjedh nga përdorimi i shërbimeve hekurudhore dhe që rezulton me vdekje, lëndim personal, humbje ose dëmtim të bagazhit të tyre;

ç) të drejtat e udhëtarëve në rast ndërprerjeje udhëtimi, të tilla si anulimi ose vonesa, duke përfshirë të drejtën e tyre për kompensim;

d) informacion minimal dhe i saktë, duke përfshirë lëshimin e biletave në një nga formatet të aksesueshëm dhe në kohë udhëtarëve;

dh) mosdiskriminimi dhe ndihma për personat me aftësi të kufizuara dhe personat me lëvizshmëri të reduktuar;

e) përcaktimin dhe monitorimin e standardeve të cilësisë së shërbimit dhe menaxhimit e rreziqeve për sigurinë personale të udhëtarëve;

ë) trajtimin e ankesave;

f) rregullat e përgjithshme për ekzekutimin.

Neni 2

Fusha e zbatimit

1. Ky udhëzim zbatohet për funksionimin e shërbimeve publike të transportit hekurudhor të udhëtarëve brenda vendit dhe me vendet kufitare, sipas marrëveshjeve të përbashkëta të organeve kompetente, të ofruar nga një ose më shumë sipërmarrje hekurudhore, të licencuara në përputhje me vendimin nr. 657, datë 31.10.2018, “Për përcaktimin e Autoritetit Licencues Hekurudhor”.

2. Ky udhëzim nuk zbatohet për shërbimet publike që bëhen kryesisht për interesat ose vlerën historike, si dhe për koncesionet e punëve publike, kontrata për interesa monetarë të lidhura me shkrim ndërmjet një ose më shumë subjekteve.

Neni 3

Përkufizime

Termat e përcaktuar në nenin 5, të ligjit nr. 142/2016, datë 22.12.2016, “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”, kanë të njëjtin kuptim në këtë udhëzim. Përveç tyre, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Transport publik i udhëtarëve” do të thotë shërbimet e transportit të udhëtarëve me interes të përgjithshëm ekonomik të ofruara për publikun në baza jodiskriminuese dhe të vazhdueshme;

2. “Shërbimet e transportit publik të udhëtarëve me hekurudhë” nënkupton transportin publik të udhëtarëve me hekurudhë, duke përjashtuar transportin e udhëtarëve me mënyra të tjera të

¹ Ky udhëzim është përafruar plotësisht me: Rregulloren (KE) nr. 1370/2007, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të Evropës, datë 23 tetor 2007, “Për shërbimet e transportit publik të udhëtarëve me hekurudhë dhe rrugë”, OJ L 315/1, datë 3.12.2007;

- Rregulloren (BE) 2016/2338 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 14 dhjetor 2016, duke amenduar Rregulloren (KE) nr. 1370/2007, lidhur me hapjen e tregut për shërbimet e transportit vendës të pasagjerëve me hekurudhë”, OJ L 354, datë 23.12.2016;

- Rregulloren (BE) 2021/782 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 29 prill 2021.

Mbi të drejtat dhe detyrimet e pasagjerëve hekurudhorë (riformim), OJ L 172, datë 17.5.2021.

- Rregullorja e Këshillit (EC) nr. 169/2009, e datës 26 shkurt 2009, “Për zbatimin e rregullave të konkurrencës për transportin hekurudhor, rrugor dhe me rrugë ujore të brendshme OJ L 61, 5.3.2009.



bazuara në shina hekurudhore, si metrotë ose tramvajet;

3. “Autoritet kompetent” do të thotë çdo autoritet publik që ka kompetencën ligjore për të ndërhyrë në transportin publik të udhëtarëve në një zonë të caktuar gjeografike ose çdo organ të ngarkuar me këtë autoritet;

4. “Kompensim për shërbimin publik” do të thotë çdo përfitim, veçanërisht financiar, i dhënë drejtpërdrejt ose tërthorazi nga një autoritet kompetent nga fondet publike gjatë periudhës së zbatimit të një detyrimi shërbimi publik ose në lidhje me atë periudhë;

5. “Dhënie e drejtpërdrejtë” do të thotë dhënie e një kontrate shërbimi publik një operatori të caktuar të shërbimit publik, pa ndonjë procedurë paraprake konkurruese tenderimi;

6. “Kontratë shërbimi publik” nënkupton një ose më shumë akte ligjorisht të detyrueshme që konfirmojnë marrëveshjen ndërmjet një autoriteti kompetent dhe një operatori të shërbimit publik për t'i besuar atij operatori të shërbimit publik menaxhimin dhe funksionimin e shërbimeve të transportit publik të pasagjerëve që u nënshtrohen detyrimeve të shërbimit publik;

Kontrata mund të përbëhet, gjithashtu, nga një vendim i miratuar nga autoriteti kompetent:

- duke marrë formën e një akti legjislativ ose rregullator individual; ose

- që përmbajnë kushte në të cilat vetë autoriteti kompetent ofron shërbimet ose ia beson ofrimin e shërbimeve të tilla një operatori të brendshëm;

7. “Kushtet e Përgjithshme të Transportit” do të thotë kushtet e transportuesit në formën e kushteve të përgjithshme ose tarifave në fuqi që janë bërë me lidhjen e kontratës së transportit, pjesë përbërëse e tij;

8. “Vlerë” do të thotë vlera e një shërbimi, një itinerari, një kontrate shërbimi publik ose një skeme kompensimi për transportin publik të udhëtarëve që korrespondon me shpërblimin total, pa TVSH, të operatorit ose operatorëve të shërbimit publik, duke përfshirë kompensimin e çfarëdo lloji të paguar nga autoritetet publike dhe të ardhurat nga shitja e biletave, të cilat nuk i kthehen autoritetit kompetent në fjalë;

9. “Rregull i përgjithshëm” do të thotë një masë që zbatohet pa diskriminim për të gjitha shërbimet e transportit publik të udhëtarëve të të njëjtit lloj në

një zonë të caktuar gjeografike për të cilën është përgjegjës një autoritet kompetent;

10. “Shërbime të integruara të transportit publik të udhëtarëve” do të thotë shërbime transporti të ndërlidhura brenda një zone gjeografike të përcaktuar me një shërbim të vetëm informacioni, skemë të biletave dhe orar;

11. “Administrues stacioni” do të thotë një ent organizativ, i cili është bërë përgjegjës për menaxhimin e një ose më shumë stacioneve hekurudhore dhe që mund të jetë administratori i infrastrukturës;

12. “Operator turistik” do të thotë një tregtar ose shitës me pakicë që kombinon dhe shet ose ofron për shitje paketa, drejtpërdrejt ose nëpërmjet një tregtari tjetër ose së bashku me një tregtar tjetër, ose tregtari që i transmeton të dhënat e udhëtarit një tregtari tjetër, përveç një sipërmarrjeje hekurudhore;

13. “Shitësi i biletave” do të thotë çdo shitës me pakicë të shërbimeve të transportit hekurudhor që shet bileta, duke përfshirë biletat, në bazë të një kontrate ose marrëveshjeje tjetër ndërmjet shitësit me pakicë dhe një ose më shumë sipërmarrjeje hekurudhore;

14. “Biletë” do të thotë dëshmi e vlefshme, pavarësisht nga forma e saj, e lidhjes së një kontrate transporti;

15. “Rezervim” do të thotë një autorizim, në letër ose në formë elektronike, që jep të drejtën për transport, subjekt i marrëveshjeve të personalizuar të transportit të konfirmuara më parë;

16. “Nëpërmjet biletës” do të thotë një biletë ose bileta që përfaqësojnë një kontratë transporti për shërbime të njëpasnjëshme hekurudhore të operuara nga një ose më shumë sipërmarrje hekurudhore;

17. “Shërbim” do të thotë një shërbim transporti hekurudhor udhëtarësh që operon ndërmjet stacioneve hekurudhore, sipas një orari, duke përfshirë shërbimet e transportit të ofruara për ridrejtim;

18. “Udhëtim” do të thotë transporti i një udhëtarit ndërmjet stacionit të nisjes dhe stacionit të mbërritjes;

19. “Shërbimi i udhëtarëve hekurudhor vendës” do të thotë një shërbim hekurudhor udhëtarësh që nuk kalon kufirin shtetëror;

20. “Shërbimi i udhëtarëve hekurudhorë urbanë, periferikë dhe rajonale” do të thotë një shërbim hekurudhor udhëtarësh, qëllimi kryesor i të cilit



është për të përmbushur nevojat e një qendre urbane apo rajonale;

21. “Shërbimi i udhëtarëve hekurudhorë në distanca të gjata” do të thotë një shërbim hekurudhor udhëtarësh, i cili nuk është një shërbim hekurudhor për udhëtarët urbanë, periferikë ose rajonalë;

22. “Shërbimi ndërkombëtar i udhëtarëve hekurudhorë” do të thotë një shërbim hekurudhor udhëtarësh që kalon të paktën një kufi shtetëror, qëllimi kryesor i të cilit është të transportojë udhëtarët ndërmjet stacioneve të vendosura në shtete të ndryshme;

23. “Vonesë” do të thotë diferenca kohore midis kohës që udhëtari ishte planifikuar të mbërrinte, në përputhje me orarin e publikuar dhe kohën e mbërritjes së tij ose të saj aktuale ose të pritshme në stacionin e destinacionit;

24. “Mbërritja” do të thotë momenti kur dyert e trenit hapen në stacionin e destinacionit dhe lejohet zbritja;

25. “Abone” ose “biletë sezoni” do të thotë një biletë për një numër të pakufizuar udhëtimesh që i siguron mbajtësit udhëtimin hekurudhor në një rrugë ose rrjet të caktuar gjatë një periudhe të caktuar;

26. “Udhëtim i humbur” është një situatë ku një udhëtar humbet një ose më shumë shërbime gjatë një udhëtimi hekurudhor, të shitur në formën e një bilete, si rezultat i vonesës ose i anulimit të një ose më shumë shërbimeve të mëparshme, ose nisja e një shërbimi përpara kohës së planifikuar të nisjes;

27. “Person me aftësi të kufizuara” dhe “person me lëvizshmëri të reduktuar” do të thotë çdo person që ka një dëmtim të përhershëm ose të përkohshëm fizik, mendor, intelektual ose shqisor, i cili, në ndërveprim me pengesa të ndryshme, mund të pengojë përdorimin e tij të plotë dhe efektiv të transportit në një bazë të barabartë me udhëtarët e tjerë ose lëvizshmëria e të cilëve gjatë përdorimit të transportit është zvogëluar për shkak të moshës;

28. “Stacion” do të thotë një vendndodhje në një hekurudhë ku një shërbim hekurudhor udhëtarësh mund të fillojë, të ndalet ose të përfundojë;

29. “Automjet” do të thotë një mjet motorik ose një rimorkio që bartet me rastin e transportit të udhëtarëve.

Neni 4

Specifikimi i detyrimeve të shërbimit publik

1. Autoriteti kompetent përcakton specifikimet për detyrimet e shërbimit publik në ofrimin e shërbimeve të transportit publik të udhëtarëve dhe fushën e zbatimit të tyre. Kjo përfshin mundësinë e grupimit të shërbimeve që mbulojnë koston me shërbime që nuk mbulojnë koston.

2. Gjatë përcaktimit të këtyre specifikimeve dhe fushëveprimit të zbatimit të tyre, autoriteti kompetent respekton siç duhet parimin e proporcionalitetit.

3. Specifikimet hartohen në përputhje me objektivat e politikave të deklaruara në dokumentet e politikave të transportit publik. Përmbajtja dhe formati i dokumenteve të politikave të transportit publik dhe procedurat për konsultimin me palët përkatëse të interesuara përcaktohen në përputhje me legjislacionin kombëtar.

4. Specifikimi i detyrimeve të shërbimit publik dhe kompensimi përkatës i efektit financiar neto të detyrimeve të shërbimit synon:

a) të arrihen objektivat e politikës së transportit publik me kosto efektive; dhe

b) të mbështesin financiarisht ofrimin e transportit publik të udhëtarëve, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në politikën e transportit publik në afat të gjatë.

KREU II

KONTRATAT E SHËRBIMIT PUBLIK

Neni 5

Përmbajtja e detyrueshme e kontratave të shërbimit publik

1. Në vijim të neneve 150 deri 153, të ligjit nr. 142/2016, datë 22.12.2016, “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”, janë dhe përcaktimet:

a) Kontratat e shërbimeve publike dhe rregullat e përgjithshme përcaktojnë marrëveshjet për shpërndarjen e kostove që lidhen me ofrimin e shërbimeve. Këto kosto përfshijnë në veçanti kostot e personelit, energjisë, tarifave të infrastrukturës, mirëmbajtjes dhe riparimit të mjeteve hekurudhore të transportit publik, mjeteve hekurudhore dhe instalimet e nevojshme për funksionimin e shërbimeve të transportit të udhëtarëve, kostot fikse



dhe një kthim të përshtatshëm të kapitalit të përdorur.

b) Kontratat e shërbimeve publike dhe rregullat e përgjithshme përcaktojnë modalitetet për ndarjen e të ardhurave nga shitja e biletave, të cilat mund të mbahen nga operatori i shërbimit publik, të rimbursohen tek autoriteti kompetent ose të ndahen në mes të dyve.

c) Kontrata e shërbimit publik mund të zgjatet me një maksimum prej 50%, nëse:

i. operatori i shërbimit publik ofron asete, të cilat janë të rëndësishme në lidhje me asetet e përgjithshme të nevojshme për të kryer shërbimet e transportit të udhëtarëve;

ii. justifikohet nga kostot që rrjedhin nga situata e veçantë gjeografike në rajonet më të largëta;

iii. justifikohet nga amortizimi i kapitalit, në lidhje me infrastrukturën, mjetet hekurudhore ose mjetet e investimeve;

iv. kontrata e shërbimit publik jepet në një procedurë tenderimi konkurrues të drejtë dhe në këtë rast, për të garantuar transparencë, autoriteti kompetent i transmeton Komisionit të BE-së, më poshtë Komisionin, brenda një viti nga lidhja e kontratës, kontratën e shërbimit publik dhe elementet që justifikojnë zgjatjen e saj.

ç) Në zbatimin e kontratave të shërbimit publik, operatorët e shërbimeve publike respektojnë detyrimet e zbatueshme në fushën e legjislacionit në fuqi për marrëdhëniet e punës, sociale ose marrëveshjet kolektive.

d) Në rast ndryshimi të operatorit të shërbimit publik, të bizneseve ose pjesëve të sipërmarrjeve, kur një ndryshim i tillë përbën një transferim të sipërmarrjes, zbatohen aktet ligjore për mbrojtjen e të drejtave të punonjësve në rast transferimesh.

dh) Kontratat e shërbimit publik japin detaje transparente të të drejtave kontraktuale të personelit të marrë më parë nga operatori i përzgjedhur i shërbimit publik për të ofruar shërbime dhe kushte, në të cilat punonjësit janë të lidhur me shërbimet. Këto kërkesa që operatorët e shërbimeve publike, të respektojnë standarde cilësore dhe sociale, përfshihen në dokumentet e tenderit, duke vendosur kritere sociale dhe cilësore të cilat më pas përfshihen në kontratat e shërbimit publik.

e) Dokumentet e tenderit dhe kontratat për shërbimet publike tregojnë, në mënyrë transparente, nëse dhe në çfarë mase, nënkontraktimi është i lejuar. Nëse bëhet nënkontraktim, operatorit që i

është besuar administrimi dhe kryerja e shërbimeve të transportit publik të udhëtarëve në përputhje me këtë udhëzim i kërkohet të kryejë vetë një pjesë të madhe të shërbimeve të transportit publik të udhëtarëve. Një kontratë shërbimi publik që mbulon njëkohësisht projektimin, ndërtimin dhe funksionimin e shërbimeve të transportit publik të udhëtarëve mund të lejojë nënkontraktim të plotë për funksionimin e këtyre shërbimeve. Kontrata për shërbimin publik, në përputhje me ligjin kombëtar, përcakton kushtet e zbatueshme për nënkontraktim.

ë) Kontratat e shërbimit publik kërkojnë nga operatori t'i sigurojë autoritetit kompetent informacionin thelbësor për dhënien e kontratave të shërbimit publik. Autoriteti kompetent jep informacionin përkatës për përgatitjen e një oferte, sipas një procedure tenderimi konkurrues dhe garantimin e mbrojtjes legjitime të informacionit konfidencial të biznesit. Informacioni përfshin kërkesën mbi numrin e udhëtarëve, tarifat, kostot dhe të ardhurat në lidhje me transportin publik të udhëtarëve, të mbuluar nga procedura e tenderit konkurrues, si dhe detajet e specifikimeve të infrastrukturës përkatëse për funksionimin e mjeteve të kërkuara hekurudhore. Kjo iu mundëson palëve të interesuara të hartojnë planin e biznesit me informacionin e duhur. Administratorët e infrastrukturës hekurudhore mbështesin autoritetin kompetent në ofrimin e të gjitha specifikimeve përkatëse të infrastrukturës. Mosrespektimi i këtij detyrimi do t'i nënshtrohet rishikimit ligjor të parashikuar në pikën 7 të nenit 6.

f) Autoriteti kompetent mund të përjashtojë nga objekti i këtij udhëzimi rregullat e përgjithshme mbi kompensimin financiar për detyrimet e shërbimit publik, të cilat përcaktojnë tarifat maksimale për nxënësit, studentët, praktikantët dhe personat me lëvizshmëri të reduktuar. Në këtë rast, autoriteti duhet të vlerësojë veçanërisht rregullat që lidhen me ndihmën shtetërore dhe ia njofton ato rregulla Komisionit të BE-së. Çdo njoftim i tillë duhet të përmbajë informacion të plotë mbi masën dhe, në veçanti, detaje mbi metodën e llogaritjes.

Neni 6

Dhënia e kontratave të shërbimit publik

1. Kontratat e shërbimeve publike jepen në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë udhëzim.



2. Çdo autoritet kompetent vendos të ofrojë vetë shërbimet e transportit publik të udhëtarëve ose të japë kontrata shërbimi publik drejtpërdrejt një subjekti tjetër mbi të cilin autoriteti ushtron kontroll të ngjashëm me atë të ushtruar mbi departamentet e veta. Kur një autoritet merr një vendim të tillë, zbatohen sa vijon:

a) për qëllime të përcaktimit, nëse autoriteti ushtron kontroll, do të merren parasysh faktorë të tillë si shkalla e përfaqësimit në organet administrative, drejtuese ose mbikëqyrëse, specifikimet që lidhen me to në statutin, pronësinë dhe kontrolli mbi vendimet strategjike të menaxhimit. Nëse pronësia është 100% nga autoriteti publik kompetent, veçanërisht në rastin e partneriteteve publiko-private, nuk është një kërkesë e detyrueshme për vendosjen e kontrollit, sipas kuptimit të këtij paragrafi;

b) kushti për zbatimin e këtij paragrafi është që operatori dhe çdo subjekt mbi të cilin ky operator ushtron një ndikim qoftë edhe minimal, të kryejnë veprimtarinë e tyre të transportit publik të udhëtarëve brenda territorit të përcaktuar nga autoriteti dhe të mos marrë pjesë në tenderat në lidhje me ofrimin e shërbimeve të transportit publik të udhëtarëve të organizuar jashtë këtyre territoreve;

c) pavarësisht nga pika “b”, një operator mund të marrë pjesë në tender konkurrues të drejtë dy vjet përpara përfundimit të kontratës së tij të shërbimit publik të dhënë drejtpërdrejt, me kusht që të jetë marrë një vendim përfundimtar për të paraqitur shërbimet e transportit publik të udhëtarëve të mbuluara nga kontrata e mëparshme për tender konkurrues të drejtë dhe se operatori i brendshëm nuk ka lidhur ndonjë kontratë tjetër të shërbimit publik të dhënë drejtpërdrejt;

ç) nëse është bërë nënkontraktimi sipas pikës 7 të nenit 5, operatorit i kërkohet të kryejë vetë pjesën më të madhe të shërbimit të transportit publik të udhëtarëve.

3. Çdo autoritet kompetent që i drejtohet një pale të tretë, përveç një operatori të brendshëm, jep kontrata për shërbime publike, në bazë të një procedure tenderimi me përjashtim të rasteve të përcaktuara në paragrafët vijues të këtij neni: 3/a, 4, 4/c, 4/ç, 5 dhe 6. Procedura e miratuar për tenderin do të jetë e hapur për të gjithë operatorët, e drejtë dhe në respektim të parimeve të transparencës dhe mosdiskriminimit. Pas dorëzimit të ofertave dhe çdo parazgjedhjeje, procedura mund të përfshijë

negociata, në përputhje me këto parime për të përcaktuar mënyrën më të mirë për të përmbushur kërkesat specifike ose komplekse.

a) Përveç rasteve kur bie ndesh me ligjin, për sa u përket kontratave të shërbimit publik për shërbimet e transportit publik të udhëtarëve me hekurudhë, të dhëna në bazë të një procedure tenderimi, autoriteti kompetent vendos të shpallë përkohësisht dhënien e kontratave të reja, drejtpërdrejt, kur konsideron se dhënia e drejtpërdrejtë është e justifikuar nga rrethana të jashtëzakonshme. Këto rrethana të jashtëzakonshme përfshijnë situata, ku:

- ka një sërë procedurash tenderimi konkurrues që tashmë janë duke u drejtuar nga autoriteti kompetent, të cilat mund të ndikojnë në numrin dhe cilësinë e ofertave që mund të pranohen, nëse kontrata është objekt i një procedure tenderimi; ose

- kërkohen ndryshime në objektin e një ose më shumë kontratave të shërbimit publik për të optimizuar ofrimin e shërbimeve publike.

b) Autoriteti kompetent nxjerr vendim të arsyetuar dhe informon Komisionin e BE-së, më poshtë Komisioni, pa vonesa të panevojshme.

c) Kohëzgjatja e kontratave të lidhura sipas këtij paragrafi është në përpjesëtim me rrethanat e jashtëzakonshme në fjalë dhe në çdo rast nuk do të kalojë 5 vjet.

ç) Autoriteti kompetent publikon kontrata të tilla, duke marrë parasysh mbrojtjen legjitime të informacionit konfidencial të biznesit dhe interesave komercialë.

d) Nuk aplikohet zgjatje kontrate apo kontratë pasuese me të njëjtat detyrime të shërbimit publik në bazë të kësaj dispozite.

dh) Në zbatim të pikës 3 të këtij neni, autoriteti kompetent vendos të zbatojnë procedurën e mëposhtme:

e) Bën publik synimin për të dhënë një kontratë shërbimi publik për shërbimet e transportit publik të udhëtarëve me hekurudhë, duke publikuar një njoftim informues në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian për tenderat ndërkombëtarë dhe në Buletinin e Prokurimeve Publike për tenderat kombëtarë, i cili përmban një përshkrim të detajuar të shërbimeve që janë objekt i kontratës që do të jepet, si dhe llojin dhe kohëzgjatjen e kontratës.

ë) Operatorët shprehin interesin e tyre brenda një periudhe të caktuar nga autoriteti kompetent, e cila



nuk duhet të jetë më pak se 60 ditë pas publikimit të njoftimit informativ.

f) Nëse pas skadimit të kësaj periudhe:

i. vetëm një operator ka shprehur interesimin e tij për të marrë pjesë në procedurën e dhënies së kontratës së shërbimit publik;

ii. ai operator ka vërtetuar siç duhet se në fakt është në gjendje të ofrojë shërbimin e transportit në përputhje me detyrimet e përcaktuara në kontratën e shërbimit publik;

iii. mungesa e konkurrencës nuk është rezultat i një kufizimi të kriterëve të prokurimit; dhe

iv. nuk ekziston asnjë alternativë e arsyeshme;

g) Autoriteti kompetent fillon negociatat me këtë operator për dhënien e kontratës pa publikim të mëtejshëm të një procedure tenderimi të hapur.

4. Përveç rasteve kur bie ndesh me ligjin, autoriteti kompetent vendos të japë kontrata për shërbime publike drejtpërdrejt:

a) kur vlera mesatare vjetore e tyre vlerësohet në më pak se 1 000 000 euro ose, në rastin e një kontrate shërbimi publik që përfshin shërbimet e transportit publik të udhëtarëve me hekurudhë, më pak se 7 500 000 euro; ose

b) kur ato kanë të bëjnë me ofrimin vjetor të më pak se 300 000 kilometrave të shërbimeve të transportit publik të udhëtarëve ose, në rastin e një kontrate shërbimi publik, duke përfshirë shërbimet e transportit publik të udhëtarëve me hekurudhë, më pak se 500 000 kilometra.

Në rastin e një kontrate shërbimi publik që i jepet drejtpërdrejt një sipërmarrjeje të vogël ose të mesme që operon jo më shumë se 23 mjete hekurudhore, ato prapë mund të rriten ose në një vlerë mesatare vjetore të vlerësuar në më pak se 2 000 000 euro ose në një provizion vjetor më pak se 600 000 kilometra shërbime të transportit publik të udhëtarëve.

c) Përveç rasteve kur bie ndesh me ligjin, autoriteti kompetent vendos të japë kontrata shërbimi publik për shërbimet e transportit publik të udhëtarëve me hekurudhë direkt:

i. kur konsideron se dhënia e drejtpërdrejtë justifikohet nga karakteristikat përkatëse strukturore dhe gjeografike të tregut dhe rrjetit në fjalë, dhe në veçanti madhësia, karakteristikat e kërkesës, kompleksiteti i rrjetit, izolimi teknik dhe gjeografik dhe shërbimet e mbuluara nga kontrata; dhe

ii. kur një kontratë e tillë sjell një përmirësim të cilësisë së shërbimeve ose të efikasitetit të kostos,

ose të dyja, krahasuar me kontratën e dhënë më parë të shërbimit publik.

ç) Mbi këtë bazë, autoriteti kompetent publikon një vendim të arsyetuar dhe informon Komisionin brenda një muaji nga publikimi i tij. Autoriteti kompetent vazhdon me dhënien e kontratës, duke përfshirë kërkesat e performancës që të jenë të matshme, transparente dhe të verifikueshme. Kërkesat e performancës mbulojnë në veçanti përpikërinë e shërbimeve, shpeshtësinë e operimeve të trenave, cilësinë e mjeteve hekurudhore dhe kapacitetin e transportit për udhëtarët.

d) Kontrata përfshin tregues specifikë të performancës që i mundësojnë autoritetit kompetent të kryejë vlerësime periodike. Kontrata përfshin, gjithashtu, masa efektive dhe parandaluese që do të vendosen në rast se sipërmarrja hekurudhore nuk arrin të përmbushë kërkesat e performancës.

dh) Autoriteti kompetent vlerëson periodikisht nëse sipërmarrja hekurudhore ka arritur objektivat e saj për përmbushjen e kërkesave të performancës, siç janë përcaktuar në kontratë dhe i bën publike gjetjet e saj. Vlerësime të tilla periodike bëhen të paktën çdo 5 vjet.

e) Autoriteti kompetent ndërmerr masat e duhura dhe në kohë, duke përfshirë vendosjen e ndëshkimeve kontraktuale efektive dhe parandaluese, nëse nuk arrihen përmirësimet e kërkuara në cilësinë e shërbimeve ose efikasitetin e kostos, ose të dyja. Autoriteti kompetent në çdo kohë pezullon ose ndërpret plotësisht ose pjesërisht kontratën e dhënë, sipas kësaj dispozite, nëse operatori nuk përmbush kërkesat e performancës.

ë) Përveç rasteve kur bie ndesh me ligjin, autoriteti kompetent vendos të japë kontrata shërbimi publik për shërbimet e transportit publik të udhëtarëve me hekurudhë, kur ato kanë të bëjnë me operimin vetëm të shërbimeve hekurudhore të udhëtarëve nga një operator që menaxhon njëkohësisht të gjithë ose pjesën më të madhe të infrastrukturës hekurudhore në të cilën ofrohen shërbimet, kur ajo infrastrukturë hekurudhore është e përjashtuar nga zbatimi i neneve 7, 8, 9, 10 dhe 15 të ligjit nr. 142/2016, datë 22.12.2016, “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”.

f) Kohëzgjatja e kontratave të shpallura drejtpërdrejt, sipas këtij paragrafi është jo më shumë se 10 vjet, përveç rasteve kur zbatohet shtyrja e kontratave.



g) Kontratat e dhëna në përputhje me këtë pikë publikohen duke marrë parasysh mbrojtjen legjitime të informacionit konfidencial të biznesit dhe interesave komerciale.

5. Në rast të ndërprerjes së shërbimeve ose rrezikut të menjëhershëm të një situate të tillë, autoriteti kompetent merr masa emergjente. Masat emergjente marrin formën e një dhënieje të drejtpërdrejtë ose të një marrëveshjeje formale për të zgjatur një kontratë shërbimi publik ose një kërkesë për të ofruar disa detyrime të shërbimit publik. Operatori i shërbimit publik ka të drejtë ankese kundër vendimit për vendosjen e ofrimit të disa detyrimeve të shërbimit publik. Periudha për të cilën kontrata e shërbimit publik jepet, zgjatet ose vendoset me masa emergjente është jo më shumë se 2 vjet.

6. Përveç rasteve kur bie ndesh me ligjin, autoriteti kompetent vendos të bëjë dhënie të drejtpërdrejta të kontratave të shërbimeve publike, me përjashtim të mënyrave të tjera, si metroja ose tramvaji dhe kontrata të tilla është më kohëzgjatje jo më shumë se 10 vjet.

a) Për të rritur konkurrencën ndërmjet sipërmarrjeve hekurudhore, autoriteti kompetent vendos që kontratat për shërbimet e transportit publik të udhëtarëve që mbulojnë të njëjtën linjë ose linja të ndryshme t'u jepen sipërmarrjeve të ndryshme hekurudhore. Për këtë qëllim, autoritetet kompetente, përpara fillimit të procedurës së tenderit, vendosin të kufizojnë numrin e kontratave për të cilën ka të drejtë të konkurrojë një sipërmarrje hekurudhore.

7. Vendimet e mësipërme të marra në përputhje me paragrafët 2 deri në 6 rishikohen nga Autoriteti Rregullator Hekurudhor në mënyrë efektive dhe të shpejtë, me kërkesën e çdo personi apo subjekti që ka ose ka pasur interes për të marrë një kontratë të caktuar dhe që ka qenë ose rrezikon të dëmtohet nga një shkelje e supozuar, me arsyetimin se vendime të tilla kanë shkelur ligjin ose rregullat që zbatojnë atë ligj.

a) Rezultati i një vlerësimi të tillë vihet në dispozicion të publikut në përputhje me legjislacionin përkatës dhe jepen gjithmonë arsyet me shkrim për vendimet e marra.

b) Vendimi i marrë nga Autoriteti Rregullator Hekurudhor është objekt shqyrtimi gjyqësor.

Neni 7

Mjetet hekurudhore

1. Autoriteti kompetent, para nisjes së një procedure tenderimi, vlerëson masat e nevojshme për të siguruar akses efektiv dhe jodiskriminues në mjetet e nevojshme hekurudhore. Ky vlerësim konsideron praninë e shoqërive të *leasing*-ut të mjeteve hekurudhore, ose të aktorëve të tjerë të tregut që ofrojnë *leasing*-un e mjeteve hekurudhore. Raporti i vlerësimit vihet në dispozicion të publikut.

2. Autoriteti kompetent, në përputhje me legjislacionin dhe me rregullat e ndihmës shtetërore, merr masa të duhura për sigurimin e aksesit të plotë dhe jodiskriminues në mjetet hekurudhore të nevojshme. Masa të tilla përfshijnë:

a) sigurimin nga autoriteti kompetent të mjeteve hekurudhore të përdorura për ekzekutimin e kontratës së shërbimit publik, me synimin për ta vënë atë në dispozicion të operatorit të përzgjedhur të shërbimit publik, me çmimin e tregut ose si pjesë e kontratës së shërbimit publik;

b) dhënie nga autoriteti kompetent të një garancie për financimin e mjeteve hekurudhore të përdorura për ekzekutimin e kontratës së shërbimit publik, me çmimin e tregut ose si pjesë e kontratës së shërbimit publik, duke përfshirë një garanci që mbulon rrezikun e vlerës së mbetur;

c) një angazhim nga autoriteti kompetent në kontratën e shërbimit publik për të marrë përsipër mjetet hekurudhore, me kushte të paracaktuara financiare në fund të kontratës me çmimin e tregut;

ç) bashkëpunim me autoritetet e tjera kompetente për të krijuar një grup më të madh mjetesh hekurudhore.

3. Nëse mjetet hekurudhore i vihen në dispozicion një operatori të ri të transportit publik, autoriteti kompetent përfshin në dokumentet e tenderit çdo informacion të disponueshëm për koston e mirëmbajtjes së mjeteve hekurudhore dhe për gjendjen e tij fizike.

Neni 8

Publikimi

1. Çdo autoritet kompetent bën publike një herë në vit një raport të përmbledhur mbi detyrimet e shërbimit publik, për të cilat është përgjegjës. Raporti përfshin:



a) datën e fillimit dhe kohëzgjatjen e kontratave të shërbimit publik;

b) operatorët e përzgjedhur të shërbimeve publike;

c) pagesat e kompensimit dhe të drejtat ekskluzive që u janë dhënë atyre operatorëve të shërbimeve publike në formë rimbursimi;

ç) bën dallimin ndërmjet transportit me autobus dhe transportit hekurudhor;

d) mundëson monitorimin dhe vlerësimin e performancës, cilësisë dhe financimit të rrjetit të transportit publik;

dh) jep informacion mbi natyrën dhe shtrirjen e çdo të drejte ekskluzive të dhënë;

e) konsideron objektivat e politikës, siç deklarohen në dokumentet e politikave të transportit publik shtetëror;

2. Çdo autoritet kompetent merr masat e nevojshme që, të paktën një vit përpara fillimit të procedurës së ftesës për tender ose një vit përpara dhënies së drejtpërdrejtë, të publikohet të paktën në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian, informacioni i mëposhtëm:

a) emri dhe adresa e autoritetit kompetent;

b) lloji i çmimit të parashikuar;

c) shërbimet dhe fushat që mbulohen nga çmimi;

ç) data e parashikuar e fillimit dhe kohëzgjatjen e kontratës së shërbimit publik.

Autoriteti kompetent vendos të mos publikojnë këtë informacion kur një kontratë shërbimi publik ka të bëjë me një ofrim vjetor prej më pak se 50 000 kilometrash shërbime të transportit publik të udhëtarëve.

d) Nëse ky informacion ndryshon pas publikimit të tij, autoriteti kompetent publikon një korrigjim, në përputhje me rrethanat, sa më shpejt të jetë e mundur. Ky korrigjim nuk paragjykon datën e fillimit të dhënies së drejtpërdrejtë ose të ftesës për tender.

dh) Ky paragraf nuk zbatohet për nenin 6, pika 5.

3. Në rastin e një dhënieje të drejtpërdrejtë të kontratave të shërbimit publik për transportin me hekurudhë, autoriteti kompetent bën publik informacionin e mëposhtëm brenda një viti nga dhënia e çmimit:

a) emrin e subjektit kontraktor, pronësinë e tij dhe, nëse është e përshtatshme, emrin e palës ose të palëve që ushtrojnë kontroll ligjor;

b) kohëzgjatja e kontratës së shërbimit publik;

c) përshkrimin e shërbimeve të transportit të udhëtarëve që do të kryhen;

ç) përshkrimin e parametrave të kompensimit financiar;

d) objektivat e cilësisë, të tilla si përpikëria, besueshmëria, shpërblimet dhe ndëshkimet e aplikueshme;

dh) kushtet në lidhje me asetet thelbësore.

4. Kur kërkohet nga një palë e interesuar, një autoritet kompetent i përcjell arsyet e vendimit të tij për dhënien e drejtpërdrejtë të një kontrate shërbimi publik.

5. Me kërkesë me shkrim të Komisionit, autoriteti kompetent komunikon, brenda një periudhe që përcaktohet në atë kërkesë, të gjithë informacionin e nevojshëm për të përcaktuar nëse kompensimi i dhënë është në përputhje me këtë udhëzim.

KREU III

KONTRATAT E TRANSPORTIT, INFORMACIONI DHE BILETAT

Neni 9

Kontrata e transportit

Lidhja, zbatimi i një kontrate transporti, dhënia e informacionit dhe e biletave rregullohen nga dispozitat e titullit I dhe titullit II të aneksit II.

Neni 10

Kushtet dhe tarifat e kontratës jodiskriminuese

1. Pa cenuar tarifat sociale, sipërmarrjet hekurudhore, shitësit e biletave ose operatorët turistikë i ofrojnë publikut të gjerë kushte dhe tarifa kontraktuale pa diskriminim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në bazë të kombësisë së udhëtarit ose të vendit të vendosjes së tyre.

2. Paragrafi i parë i këtij neni zbatohet edhe për sipërmarrjet hekurudhore dhe shitësit e biletave kur pranojnë rezervime nga udhëtarët.

Neni 11

Biçikleta

1. Në varësi të kufizimeve të përcaktuara në paragrafin 3 të këtij neni, dhe kur është e



përshtatshme për një tarifë të arsyeshme, udhëtarët kanë të drejtë të marrin biçikleta në tren.

a) Në trenat për të cilët kërkohet rezervim, bëhet një rezervim edhe për transportin e një biçiklete.

b) Kur një udhëtar bën një rezervim për një biçikletë dhe transporti i asaj biçiklete refuzohet pa një arsye të justifikuar siç duhet, udhëtarë ka të drejtë për riorientim ose rimbursim në përputhje me nenin 19, kompensim në përputhje me nenin 20, dhe ndihmë në përputhje me nenin 21, pika 2, të këtij udhëzimi.

2. Kur në tren ka vende të disponueshme për biçikleta, udhëtarët duhet të vendosin biçikletat e tyre në vende të tilla. Nëse këto vende nuk janë të disponueshme, udhëtarët i mbajnë biçikletat e tyre nën mbikëqyrje dhe kujdesen të mos shkaktojnë dëm ose dëmtim për udhëtarët e tjerë, pajisjet e tjera, bagazhet ose shërbime hekurudhore.

3. Sipërmarrjet hekurudhore kufizojnë të drejtën e udhëtarëve të marrin biçikleta në tren për arsye sigurie ose operative, veçanërisht si rezultat i kufijve të kapacitetit të zbatueshëm gjatë orëve të pikut, ose kur mjetet hekurudhore nuk e lejojnë këtë. Sipërmarrjet hekurudhore kufizojnë gjithashtu transportin e biçikletave bazuar në peshën dhe dimensionet e biçikletave në fjalë. Ata publikojnë kushtet e tyre për transportin e biçikletave, i cili përfshihet në informacionin e përditësuar mbi disponueshmërinë e kapacitetit, duke përdorur aplikacionet telematike në faqet e tyre zyrtare të internetit.

4. Sipërmarrjet hekurudhore kur blejnë mjete hekurudhore të reja ose përmirësojnë ato ekzistuese, që kërkon pajisjen me një autorizim mjeti për vendosjen në treg, të sigurojnë që kompozimet e trenave, duke marrë parasysh madhësinë e trenit, llojin e shërbimit dhe kërkesën për transportin e biçikletave, të jenë të pajisura me një numër të mjaftueshëm vendesh për biçikleta ose të ketë të paktën katër vende për biçikleta.

a) Ky nënparagraf nuk do të zbatohet në lidhje me makinat e destinuara për shërbime sociale, fjetje dhe ngrënie.

5. Sipërmarrjet hekurudhore krijojnë dhe mbajnë të përditësuara plane për mënyrën e rritjes dhe të përmirësimit të transportit të biçikletave dhe për zgjidhje të tjera që inkurajojnë përdorimin e kombinuar të hekurudhave dhe biçikletave.

a) Autoritetet kompetente, krijojnë dhe kërkojnë plane të tilla nga sipërmarrje hekurudhore për

shërbimet e ofruara, sipas kontratave të shërbimeve publike.

6. Planet përcaktohen pas konsultimit me publikun dhe organizatat përfaqësuese përkatëse. Këto plane publikohen në faqen e internetit të sipërmarrjes hekurudhore ose autoritetit kompetent, sipas rastit.

Neni 12

Qasje në informacionin e trafikut dhe udhëtimit

1. Administratorët e infrastrukturës shpërndajnë të dhëna në kohë reale, në lidhje me mbërritjen dhe nisjen e trenave për sipërmarrjet hekurudhore, shitësit e biletave, operatorët turistikë dhe administratorët e stacioneve.

2. Sipërmarrjet hekurudhore u ofrojnë sipërmarrjeve të tjera hekurudhore, shitësve të biletave dhe operatorëve turistikë që shesin shërbimet e tyre akses në informacionin minimal të udhëtimit të përcaktuar në nenin 94, të ligjit nr. 142/2016, datë 22.12.2016, “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”.

3. Informacioni dhe qasja në të shpërndahet dhe jepet në mënyrë jodiskriminuese dhe pa vonesa të panevojshme. Një kërkesë e vetme është e mjaftueshme për të pasur akses të vazhdueshëm në informacion.

a) Megjithatë, sipërmarrja hekurudhore dhe administratori i infrastrukturës mund të kërkojnë lidhjen e një kontrate ose një marrëveshje tjetër për shpërndarjen e informacionit ose qasjen në të. Termat dhe kushtet e këtyre kontratave ose marrëveshjeve lejojnë mundësitë për ripërdorimin e informacionit dhe konkurrencë të lirë.

b) Sipërmarrjet hekurudhore mund të kërkojnë nga sipërmarrjet e tjera hekurudhore, operatorët turistikë dhe shitësit e biletave një kompensim financiar të drejtë, të arsyeshëm dhe proporcional për kostot e shkaktuara në sigurimin e aksesit, ndërsa administratorët e infrastrukturës mund të kërkojnë kompensim në përputhje me rregullat e zbatueshme.

4. Informacioni shpërndahet dhe aksesit sigurohet me mjete teknike të përshtatshme, si ndërfaqet e programimit të aplikacioneve.

5. Informacioni i mbuluar nga paragrafët 1 ose 2 ofrohet në përputhje me aktet e tjera ligjore dhe detyrimet përkatëse, sipas këtij neni konsiderohen se janë përmbushur.



Neni 13

Nëpërmjet biletave

1. Kur shërbimet hekurudhore të udhëtarëve në distanca të gjata ose rajonale operohen nga një sipërmarrje e vetme hekurudhore, ajo ofron një biletë për ato shërbime. Për shërbimet e tjera hekurudhore të udhëtarëve, sipërmarrjet hekurudhore bëjnë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të ofruar bileta përmes biletave dhe bashkëpunojnë për këtë qëllim ndërmjet tyre.

a) Për qëllimin e nënparagrafit të parë, termi “sipërmarrje e vetme hekurudhore” përfshin gjithashtu të gjitha sipërmarrjet hekurudhore të cilat janë ose në pronësi të plotë të të njëjtit pronar ose që janë ndërmarrje filiale në pronësi të plotë të njëjës prej sipërmarrjeve hekurudhore të përfshira.

2. Për udhëtimet që përfshijnë një ose më shumë linja hekurudhore, udhëtari informohet përpara se të blejë një biletë ose bileta nëse ajo biletë ose ato bileta përbëjnë një biletë.

3. Për udhëtimet që përfshijnë një ose më shumë linja hekurudhore, një biletë ose bileta, të blera në një transaksion të vetëm tregtar nga një sipërmarrje hekurudhore, përbëjnë një biletë dhe sipërmarrja hekurudhore është përgjegjëse në përputhje me nenet 19, 20 dhe 21 nëse udhëtari humbet një ose më shumë lidhje.

4. Kur një biletë ose bileta blihen në një transaksion të vetëm tregtar dhe shitësi i biletave ose operatori turistik i ka kombinuar biletat me iniciativën e tij, shitësi i biletave ose operatori turistik që ka shitur biletën ose biletat është i detyruar të rimbursojë shumën totale të paguar për atë transaksion për biletën ose biletat dhe, për më tepër, të paguajë kompensim të barabartë me 75% të asaj shume, në rast se udhëtari humbet një ose më shumë linja.

a) E drejta për rimbursim ose kompensim të përmendur në nënparagrafin e parë nuk paragjykon legjislacionin kombëtar në fuqi që u jep udhëtarëve kompensim të mëtejshëm për dëmin.

5. Detyrimet e përcaktuara në paragrafët 3 dhe 4 nuk zbatohen nëse përmendet në bileta, ose në një dokument tjetër ose në mënyrë elektronike në një mënyrë të tillë që i mundëson udhëtarit të riprodhojë informacionin për referencë në të ardhmen, që biletat përfaqësojnë kontrata të veçanta transporti, dhe udhëtari ishte informuar për këtë para blerjes.

6. Barrën e provës se udhëtarit i është dhënë informacioni i përmendur në këtë nen, e ka sipërmarrja hekurudhore, operatori turistik ose shitësi i biletave që ka shitur biletën ose biletat.

7. Shitësit e biletave ose operatorët turistikë janë përgjegjës për trajtimin e kërkesave dhe ankesave të mundshme të udhëtarit, sipas paragrafit 4. Rimbursimi dhe kompensimi i përmendur në paragrafin 4 do të paguhet brenda 30 ditëve pas marrjes së kërkesës.

KREU IV

**PËRGJEGJËSIA E SIPËRMARRJEVE
HEKURUDHORE PËR UDHËTARËT DHE
BAGAZHET E TYRE**

Neni 14

Përgjegjësia për udhëtarët dhe bagazhet

Në varësi të dispozitave të këtij kreu që u jep udhëtarëve kompensim të mëtejshëm për dëmet, përgjegjësia e sipërmarrjeve hekurudhore në lidhje me udhëtarët dhe bagazhet e tyre rregullohet nga krerët I, III dhe IV të titujve III, V dhe VI të aneksit II.

Neni 15

Sigurimi dhe mbulimi i përgjegjësisë

Një sipërmarrje hekurudhore, duhet të jetë siguruar në mënyrë të mjaftueshme ose të ketë garanci të mjaftueshme financiare në kushtet e tregut për të mbuluar, në përputhje me ligjin kombëtar dhe ndërkombëtar, detyrimet e saj, në rastet e aksidenteve, veçanërisht në lidhje me udhëtarët, bagazhin, mallin, postën dhe palët e treta. Pavarësisht këtij detyrimi, mund të merren parasysh specifikat dhe profilin e rrezikut të llojeve të ndryshme të shërbimeve, në veçanti të udhëtimeve hekurudhore për qëllime kulturore ose të trashëgimisë.

Neni 16

Paradhëniet

1. Nëse një udhëtar vritet ose plagoset, sipërmarrja hekurudhore e përmendur në nenin 16, pika 5, të aneksit II bën pa vonesë dhe në çdo rast jo më vonë se 15 ditë pas përcaktimit të identitetit të personit fizik që ka të drejtë kompensim, pagesa të



tilla paradhënie që mund të kërkohen për të plotësuar nevojat e menjëhershme ekonomike në një bazë proporcionale me dëmin e pësuar.

2. Pa cenuar paragrafin 1, një paradhënie nuk duhet të jetë më pak se 21 000 euro për udhëtar në rast vdekjeje.

3. Një pagesë paradhënie nuk përbën njohje detyrimi dhe mund të kompensohet me çdo shumë të mëvonshme të paguar në bazë të këtij udhëzimi, por nuk kthehet, përveç rasteve kur dëmi është shkaktuar nga neglizhenca ose faji i udhëtarit ose kur personi që ka marrë parapagimin nuk ishte personi që kishte të drejtë për kompensim.

Neni 17

Kontestimi i përgjegjësisë

Edhe nëse sipërmarrja hekurudhore kundërshton përgjegjësinë e saj për dëmtimin fizik të një udhëtarit, ajo bën çdo përpjekje të arsyeshme të ndihmojë udhëtarin, në lidhje me kërkesën e tij ose të saj për kompensimin e dëmit nga palët e treta.

KREU V

VONESAT, UDHËTIMET E HUMBURA DHE ANULIMET

Neni 18

Përgjegjësia për vonesat, udhëtimet e humbura dhe anulimet

Në varësi të dispozitave të këtij kreu, përgjegjësia e sipërmarrjeve hekurudhore, në lidhje me vonesat, udhëtimet e humbura dhe anulimet rregullohet nga kreu II i titullit III të shtojcës II.

Neni 19

Rimbursimi dhe ridrejtimi

1. Në rast të një udhëtimi të humbur ose anulimi, dhe nëse mbërritja në destinacionin përfundimtar ndodh me një vonesë prej 60 minutash ose më shumë, sipërmarrja hekurudhore përgjegjëse për shërbimin e vonuar ose të anuluar, i ofron udhëtarit zgjedhjen midis një prej këtyre opsioneve:

a) një biletë tjetër falas për një datë dhe orar të njëjtë të udhëtimit të vonuar ose të anuluar;

b) kthim të vlerës së biletës së blerë për udhëtimin e vonuar ose të anuluar;

c) një biletë tjetër për një datë dhe orar të ndryshëm, në qoftë se udhëtarit e dëshiron;

ç) transportin falas në vendin e caktuar të destinacionit, nëse udhëtarit nuk ka nevojë të bëjë udhëtimin më tej;

d) kujdes dhe ndihmë për akomodim dhe ushqim, nëse kjo është e nevojshme për shkak të vonesës së shërbimit të hekurudhës.

2. Pavarësisht nëse ridrejtimi operohet nga e njëjta sipërmarrje hekurudhore apo një sipërmarrje tjetër kjo nuk do të sjellë kosto shtesë për udhëtarin. Kjo kërkesë zbatohet gjithashtu kur ridrejtimi përfshin përdorimin e transportit të një klase shërbimi më të lartë dhe mënyrave alternative të transportit.

a) Sipërmarrjet hekurudhore bëjnë përpjekje të arsyeshme të shmangin udhëtimet shtesë dhe sigurojnë që vonesa në kohën totale të udhëtimit të jetë sa më e shkurtër e mundur.

b) Udhëtarët nuk zbresin në mjetet e transportit të një klase më të ulët, përveç rasteve kur këto lehtësira janë të vetmet mjete të disponueshme të ridrejtimit.

3. Pa paragjykuar paragrafin 2, sipërmarrja hekurudhore lejon udhëtarin, me kërkesën e tij ose të saj, të lidhë kontrata me ofrues të tjerë të shërbimeve të transportit, të cilat i mundësojnë të arrijë në destinacionin përfundimtar në kushte të krahueshme, rast në të cilin sipërmarrja hekurudhore rimbursos udhëtarin për shpenzimet që ai ose ajo ka.

a) Kur opsionet e disponueshme të ridrejtimit nuk i komunikohen udhëtarit brenda 100 minutave nga koha e planifikuar e nisjes së shërbimit të vonuar ose të anuluar ose udhëtimit të humbur, udhëtarit ka të drejtë të lidhë një kontratë të tillë me ofrues të tjerë të shërbimeve të transportit publik me hekurudhë ose me autobus. Sipërmarrja hekurudhore i rimbursos udhëtarit shpenzimet e nevojshme, të përshtatshme dhe të arsyeshme që ai ose ajo ka.

b) Ky paragraf nuk do të ndikojë në ligjet, rregulloret ose dispozitat administrative kombëtare që u japin udhëtarëve kushte më të favorshme të ridrejtimit.

4. Ofruesit e shërbimeve të transportit të ridrejtimit u ofrojnë personave me aftësi të kufizuara dhe personave me lëvizshmëri të reduktuar një nivel të krahueshëm ndihme dhe aksesueshmërie, shërbime alternative që janë të përshtatshme për



nevojat e tyre dhe që ndryshojnë nga ato që u ofrohen udhëtarëve të tjerë.

5. Rimbursimet e përmendura në pikën “b” të paragrafit 1 dhe në paragrafin 3 paguhen brenda 30 ditëve pas marrjes së kërkesës. Sipërmarrjet hekurudhore pranojnë kërkesa të tilla me mjete të veçanta komunikimi, me kusht që kërkesa të mos krijojë efekte diskriminuese.

a) Rimbursimi mund të marrë formën e kuponëve dhe/ose të ofrimit të shërbimeve të tjera me kusht që kushtet e këtyre kuponëve dhe/ose shërbimeve të jenë mjaft fleksibël, veçanërisht në lidhje me periudhën e vlefshmërisë dhe destinacionin, dhe që udhëtari të pranojë ato kuponë dhe/ose shërbime.

b) Rimbursimi i çmimit të biletës nuk reduktohet nga kostot e transaksionit financiar si tarifat, kostot e telefonit apo pullat.

6. Kërkesa për rimbursim bëhet sipas formularit të dhënë nga sipërmarrja hekurudhore në një format të aksesueshëm për personat me aftësi të kufizuara dhe personat me lëvizshmëri të reduktuar.

7. Udhëtarët kanë të drejtë të paraqesin kërkesat e tyre, duke përdorur formularin e përmendur në paragrafin 6. Sipërmarrjet hekurudhore nuk refuzojnë një kërkesë për rimbursim vetëm me arsyetimin se udhëtari nuk e ka përdorur atë formular. Nëse një kërkesë nuk është mjaftueshëm e saktë, sipërmarrja hekurudhore i kërkon udhëtarit të plotësojë kërkesën dhe e ndihmon udhëtarin për ta bërë këtë.

Neni 20 Kompensimi

1. Pa humbur të drejtën e transportit, një udhëtar ka të drejtën e kompensimit për vonesat nga sipërmarrja hekurudhore, nëse ai ose ajo përballet me një vonesë midis vendeve të nisjes dhe destinacionit përfundimtar të shënuar në biletë ose në biletë për të cilën kosto nuk është rimbursuar, në përputhje me nenin 19. Kompensimi minimal për vonesat do të jetë si më poshtë:

a) 25% e çmimit të biletës për një vonesë prej 60 deri në 119 minutash;

b) 50% e çmimit të biletës për një vonesë prej 120 minutash ose më shumë.

2. Paragrafi 1 zbatohet edhe për udhëtarët që përdorin abone. Nëse këta udhëtarë hasin vonesa ose anulime të përsëritura gjatë periudhës së

vlefshmërisë së abonesë, ata kanë të drejtën e kompensimit të përshtatshëm, në përputhje me marrëveshjet e kompensimit të sipërmarrjes hekurudhore:

a) këto rregullime përcaktojnë kriteret për përcaktimin e vonesës dhe për llogaritjen e kompensimit;

b) kur vonesat më pak se 60 minuta ndodhin në mënyrë të përsëritur gjatë periudhës së vlefshmërisë së abonesë, vonesat numërohen në mënyrë kumulative dhe udhëtarët kompensohen në përputhje me marrëveshjet e kompensimit të sipërmarrjes hekurudhore.

3. Pa cenuar paragrafin 2, kompensimi për vonesën llogaritet në lidhje me çmimin e plotë që udhëtari ka paguar realisht për shërbimin e vonuar:

a) kur kontrata e transportit është për një udhëtim kthimi, kompensimi për vonesën në pjesën e jashtme ose të kthimit llogaritet në lidhje me çmimin e treguar për atë pjesë të udhëtimit në biletë.

b) kur nuk ka një tregues të tillë të çmimit të pjesëve individuale të udhëtimit, kompensimi llogaritet në lidhje me gjysmën e çmimit të paguar për biletën;

c) në të njëjtën mënyrë, çmimi për një shërbim me vonesë të ofruar sipas çdo forme tjetër të kontratës së transportit llogaritet në proporcion me çmimin e plotë.

4. Llogaritja e periudhës së vonesës nuk merr parasysh asnjë vonesë që sipërmarrja hekurudhore demonstroi se ka ndodhur jashtë vendit.

5. Kërkesa për kompensim bëhet sipas formularit të dhënë nga sipërmarrja hekurudhore në një format të aksesueshëm për personat me aftësi të kufizuara dhe personat me lëvizshmëri të reduktuar.

6. Udhëtarët kanë të drejtë të paraqesin kërkesat e tyre, duke përdorur formularin e përmendur në paragrafin 5. Sipërmarrjet hekurudhore nuk refuzojnë një kërkesë për kompensim vetëm me arsyetimin se udhëtari nuk e ka përdorur atë formular. Nëse një kërkesë nuk është mjaftueshëm e saktë, sipërmarrja hekurudhore i kërkon udhëtarit të plotësojë kërkesën dhe e ndihmon udhëtarin për ta bërë këtë.

7. Kompensimi i çmimit të biletës paguhet brenda një muaji nga data e paraqitjes së kërkesës për kompensim. Kompensimi mund të paguhet në kuponë dhe/ose shërbime të tjera nëse kushtet janë të pranueshme, veçanërisht në lidhje me periudhën e vlefshmërisë dhe destinacionin.



a) Kompensimi paguhet në të holla me kërkesë të udhëtarit.

8. Kompensimi i çmimit të biletës nuk zvogëlohet nga kostot e transaksionit financiar si tarifat, kostot e telefonit apo pullat. Sipërmarrjet hekurudhore vendosin një prag minimal nën të cilin nuk do të paguhet pagesat për kompensim. Ky prag nuk duhet të kalojë 4 euro për biletë.

9. Udhëtarët nuk kanë asnjë të drejtë kompensimi nëse informohen për një vonesë përpara se të blejnë një biletë, ose nëse vonesa për shkak të vazhdimit të një shërbimi tjetër ose ridrejtimit mbetet nën 60 minuta.

10. Sipërmarrja hekurudhore nuk është e detyruar të paguajë dëmshpërblim nëse mund të provojë se vonesa, udhëtimi i humbur ose anulimi është shkaktuar drejtpërdrejt ose ka qenë e lidhur në thelb me:

a) rrethana të jashtëzakonshme që nuk lidhen me funksionimin e hekurudhës, si kushtet ekstreme të motit, fatkeqësitë e mëdha natyrore ose krizat e mëdha të shëndetit publik, të cilat sipërmarrja hekurudhore, pavarësisht se kishte marrë kujdesin e kërkuar në rrethanat e veçanta të rastit, nuk ishte në gjendje ta shmangte dhe pasojat e të cilave nuk ishte në gjendje t'i parandalonte;

b) faji i udhëtarit; ose

c) sjelljen e një pale të tretë, të cilën sipërmarrja hekurudhore, pavarësisht se kishte marrë kujdesin e kërkuar në rrethanat e veçanta të rastit, nuk ishte në gjendje ta shmangte dhe pasojat e të cilave nuk ishte në gjendje t'i parandalonte, si p.sh. persona në binarë, vjedhje kabllorsh, emergjenca në tren, aktivitete të zbatimit të ligjit, sabotim ose terrorizëm.

d) Grevat nga personeli i sipërmarrjes hekurudhore, veprimet ose mosveprimet nga një sipërmarrje tjetër që përdor të njëjtën infrastrukturë hekurudhore dhe veprimet ose mosveprimet e administratorëve të infrastrukturës dhe stacioneve nuk mbulohen nga përjashtimi i përmendur në pikën "c" të nënparagrafit të parë.

Neni 21

Ndihma në rast vonesash

1. Në rast të një vonese në mbërritje ose në nisje, ose anulim të një udhëtimi, udhëtarët informohen për situatën dhe për kohën e parashikuar të nisjes dhe kohën e parashikuar të mbërritjes ose të shërbimit të zëvendësimit nga sipërmarrja

hekurudhore ose nga administratori i stacionit, sapo të jetë i disponueshëm një informacion i tillë.

a) Kur shitësit e biletave dhe operatorët turistikë kanë një informacion të tillë, ata gjithashtu ia japin atë udhëtarit.

2. Kur vonesa e përmendur në paragrafin 1 arrin në 60 minuta ose më shumë, ose udhëtimi anulohet, sipërmarrja hekurudhore u ofron udhëtarëve pa pagesë:

a) vaktet dhe pijet freskuese, në lidhje të arsyeshme me kohën e pritjes, nëse ato janë të disponueshme në tren ose në stacion, ose mund të ofrohen në mënyrë të arsyeshme, duke marrë parasysh kriteret të tilla, si: distanca nga furnizuesi, koha e nevojshme për dorëzim dhe kostoja;

b) hotel ose akomodim tjetër dhe transport ndërmjet stacionit hekurudhor dhe vendit të akomodimit, në rastet kur bëhet i nevojshëm qëndrimi për një ose më shumë net ose bëhet i nevojshëm një qëndrim shtesë, ku dhe kur është e mundur fizikisht.

3. Brenda tridhjetë ditëve pas marrjes së njoftimit të përmendur në paragrafin 2, personi që ka pasur bagazhin mund të kërkojë t'i dorëzohet bagazhi. Në këtë rast ai duhet të paguajë tarifat duke përfshirë çdo kosto tjetër, në lidhje me transportin e sendit apo bagazhit nga vendi i dërgesës në vendin ku kryhet dorëzimi dhe të kthejë kompensimin e marrë më parë. Megjithatë, ai do të ruajë të drejtat e tij për të kërkuar kompensim për vonesën e dorëzimit të parashikuar në nenin 32.

4. Nëse bagazhi i rikuperuar nuk është kërkuar brenda periudhës së përcaktuar në paragrafin 3 ose nëse është rikuperuar më shumë se një vit pas kërkesës për dorëzim, transportuesi e disponon atë në përputhje me ligjet dhe rregullat në fuqi.

Neni 30

Kompensimi për humbjen

1. Në rast të humbjes së plotë ose të pjesshme të bagazhit të regjistruar, transportuesi pagan, duke përjashtuar të gjitha dëmet e tjera:

a) nëse vërtetohet shuma e humbjes ose dëmit të pësuar, kompensim i barabartë me atë shumë, por jo më shumë se 80 njësi llogarie për kilogram bruto ose 1 200 njësi llogarie për artikull bagazh;

b) nëse shuma e humbjes ose dëmit të pësuar nuk përcaktohet, dëmet likuidohen prej 20 njësi llogarie për kilogram bruto ose 300 njësi llogarie për artikull bagazh.

Mënyra e kompensimit, sipas kilogramëve të humbur ose sipas bagazhit, përcaktohet nga Kushtet e Përgjithshme të Transportit.

2. Transportuesi rimbursos gjithashtu tarifën për transportin e bagazhit dhe shumat e tjera të paguara në lidhje me transportin e sendit të humbur, si dhe detyrimet doganore dhe akcizat e paguara tashmë.



Neni 31

Kompensimi për dëmin

1. Në rast dëmtimi të bagazhit të regjistruar, transportuesi duhet të paguajë kompensim të barabartë me humbjen në vlerë të bagazhit, duke përfshirë të gjitha dëmtimet e tjera.

2. Kompensimi nuk duhet të kalojë:

a) nëse i gjithë bagazhi ka humbur vlerën për shkak të dëmtimit, shuma që do të ishte e pagueshme në rast të humbjes totale;

b) nëse vetëm një pjesë e bagazhit ka humbur vlerën për shkak të dëmtimit, shuma që do të ishte e pagueshme nëse ajo pjesë do të kishte humbur.

Neni 32

Kompensimi për vonesën në dorëzim

1. Në rast vonese në dorëzimin e bagazhit të regjistruar, transportuesi paguan për çdo periudhë të plotë prej 24 orësh pasi është kërkuar dërgesa, por me një maksimum prej 14 ditësh:

a) nëse personi që ka bagazhin provon se humbja ose dëmi është pësuar nga kjo, kompensimi është i barabartë me shumën e humbjes ose dëmit, deri në maksimum 0,80 njësi llogarie për kilogram të masës bruto të bagazhit ose 14 njësi llogarie për bagazhin e dorëzuar me vonesë;

b) nëse personi që ka bagazhin nuk provon se është pësuar humbje ose dëmtim, likuidohen dëmet prej 0,14 njësi llogarie për kilogram të masës bruto të bagazhit ose 2,80 njësi llogarie për artikull bagazhi, të dorëzuara me vonesë.

Metodat e kompensimit, sipas kilogramëve të humbur ose sipas bagazhit, përcaktohen nga Kushtet e Përgjithshme të Transportit.

2. Në rast të humbjes totale të bagazhit, kompensimi i parashikuar në pikën 1 nuk paguhet përveç atij të parashikuar në nenin 30.

3. Në rast të humbjes së pjesshme të bagazhit, kompensimi i parashikuar në paragrafin 1 do të paguhet për atë pjesë të bagazhit që nuk ka humbur.

4. Në rast dëmtimi të bagazhit që nuk rezulton nga vonesa në dorëzim, kompensimi i parashikuar në paragrafin 1, sipas rastit, do të paguhet, përveç atij të parashikuar në nenin 31.

5. Në asnjë rast totali i kompensimit të parashikuar në paragrafin 1 së bashku me atë të pagueshëm sipas neneve 30 dhe 31 nuk do të kalojë

kompensimin që paguhet në rast të humbjes totale të bagazhit.

**SEKSIONI 3
AUTOMJETET**

Neni 33

Kompensimi për vonesën

1. Në rast vonese në ngarkim për një arsye që i atribuohet transportuesit ose vonese në dorëzimin e një automjeti, transportuesi, nëse pronari i bagazhit provon se është pësuar humbje ose dëmtim, duhet të paguajë kompensim që nuk e kalon shumën e tarifës së transportit.

2. Nëse, në rast vonese në ngarkim për një arsye që i atribuohet transportuesit, pronari i bagazhit zgjedh të mos vazhdojë me kontratën e transportit, i kthehet tarifa e transportit. Përveç kësaj, pronari i bagazhit, nëse provon se ka pësuar humbje ose dëmtim si rezultat i vonesës, mund të kërkojë kompensim që nuk e kalon shumën e tarifës së transportit.

Neni 34

Kompensimi për humbjen

Në rast të humbjes së plotë ose të pjesshme të një automjeti, kompensimi që i paguhet personit të autorizuar për humbjen ose dëmin e provuar llogaritet në bazë të vlerës së zakonshme të mjetit. Nuk duhet të kalojë 8 000 njësi llogarie. Një rimorkio me ngarkesë ose bosh konsiderohet si mjet i veçantë.

Neni 35

Përgjegjësia në lidhje me artikujt e tjerë

1. Në lidhje me artikujt brenda automjetit ose të vendosura në kuti (p.sh. kuti bagazhesh ose kuti skish) të fiksuara në mjet, transportuesi është përgjegjës vetëm për humbjen ose dëmtimin e shkaktuar nga faji i tij. Kompensimi total i pagueshëm nuk kalon 1 400 njësi llogarie.

2. Për sa i përket artikujve të vendosur në pjesën e jashtme të mjetit, duke përfshirë kutitë e përmendura në paragrafin 1, transportuesi mban përgjegjësi vetëm nëse provohet se humbja ose dëmtimi u shkaktuan nga një veprim ose mosveprim i transportuesit, me qëllim për të shkaktuar dëme,



ose në mënyrë të pakujdesshme dhe duke e ditur se një humbje ose dëmtim i tillë mund të ndodhë.

3. Në varësi të dispozitave të këtij seksioni, dispozitat e seksionit 2, në lidhje me përgjegjësinë për bagazhet, zbatohen për automjetet.

KREU IV DISPOZITA TË PËRGJËJTHSHME

Neni 36 Kufizimi i përgjegjësisë

Kufijtë e përgjegjësisë të parashikuara në këto rregulla, si dhe dispozitat ligjore në fuqi, të cilat kufizojnë kompensimin në një shumë fikse, nuk zbatohen nëse vërtetohet se humbja ose dëmtimi rezulton nga një veprim ose mosveprim, të cilin transportuesi ka kryer ose me qëllim për të shkaktuar një humbje ose dëmtim të tillë, ose në mënyrë të pakujdesshme dhe me dijeni se një humbje ose dëmtim i tillë ka të ngjarë të ndodhë.

Neni 37 Konvertimi dhe interesi

1. Kur llogaritja e kompensimit kërkon konvertimin e shumave të shprehura në valutë të huaj, konvertimi bëhet me kursin e këmbimit të zbatueshëm në ditën dhe në vendin e pagesës së kompensimit.

2. Pronari i bagazhit mund të kërkojë kamatë kompensimi, të llogaritur në masën pesë për qind në vit, nga dita e kërkesës së parashikuar në nenin 43 ose, nëse nuk është bërë një kërkesë e tillë, nga dita në të cilën është nisur procedimi gjyqësor.

3. Megjithatë, në rastin e kompensimit të pagueshëm sipas neneve 17 dhe 18, interesi rritet vetëm nga dita në të cilën kanë ndodhur ngjarjet që kanë lidhje me vlerësimin e shumës së kompensimit, nëse ajo ditë është më vonë se ajo e kërkesës ose ditën kur është nisur procedura gjyqësore.

4. Në rastin e bagazheve, interesi paguhet vetëm nëse kompensimi tejkalon 16 njësi llogarie për kupon të regjistrimit të bagazhit.

5. Në rastin e bagazhit, nëse pronari i bagazhit nuk i dorëzon transportuesit, brenda një kohe të arsyeshme të caktuar, dokumentet mbështetëse që kërkojnë që shuma të shlyhet përfundimisht, nuk rritet interesi ndërmjet skadimit të afatit dhe dorëzimit aktual të këtyre dokumenteve.

Neni 38

Përgjegjësia në rast incidentesh bërthamore

Transportuesi lirohet nga përgjegjësia në përputhje me këto rregulla për humbjen ose dëmtimin e shkaktuar nga një incident bërthamor, kur operatori i një instalimi bërthamor ose një person tjetër që ka zëvendësuar atë është përgjegjës për humbjen ose dëmtimin, në përputhje me ligjet dhe përshtatjet që rregullojnë përgjegjësinë në fushën e energjisë bërthamore.

Neni 39

Personat për të cilët transportuesi është përgjegjës

Transportuesi është përgjegjës për nëpunësit e tij dhe personat e tjerë, shërbimet e të cilëve ai i përdor për kryerjen e transportit, kur këta nëpunës dhe persona të tjerë veprojnë brenda ushtrimit të funksioneve të tyre. Administratorët e infrastrukturës hekurudhore në të cilën kryhet transporti konsiderohen si persona shërbimet e të cilëve transportuesi i përdor për kryerjen e transportit.

Neni 40

Veprime të tjera

1. Në të gjitha rastet kur zbatohen këto rregulla, çdo veprim në lidhje me përgjegjësinë, mbi çfarëdo arsye, mund të ngrihet kundër transportuesit vetëm duke iu nënshtruar kushteve dhe kufizimeve të përcaktuara në këto rregulla.

2. E njëjta gjë do të zbatohet për çdo padë të ngritur kundër nëpunësve dhe personave të tjerë për të cilët transportuesi është përgjegjës në përputhje me nenin 39.

TTULLI IV PËRGJËJËSIA E UDHËTARIT

Neni 41

Parimet e veçanta të përgjegjësisë

Udhëtari është përgjegjës ndaj transportuesit për çdo humbje ose dëmtim:

a) që rezulton nga mospërmbushja e detyrimeve të tij në përputhje me:

1. nenin 5 dhe nenin 11, pika “b”;



2. dispozitat e veçanta për transportin e automjeteve, të përfshira në Kushtet e Përgjithshme të Transportit; ose

3. Rregullorja në lidhje me Transportin Ndërkombëtar të Mallrave të Rrezikshme me hekurudhë (RID); ose

b) shkaktuar nga artikujt dhe kafshët që ai sjell me vete,

me përjashtim të rastit kur provon se humbja ose dëmtimi ishte shkaktuar nga rrethana që ai nuk mundi t'i shmangte dhe pasojat e të cilave nuk ishte në gjendje t'i parandalonte, pavarësisht se ai zbatoi rregullat e kërkuara si një udhëtar i ndërgjegjshëm.

Kjo dispozitë nuk do të ndikojë në përgjegjësinë e transportuesit, në përputhje me nenin 16 dhe pikën 1, të nenit 22.

TITULLI V KUFIZIMI I TË DREJTAVE

Neni 42

Konstatimi i humbjes ose dëmtimit të pjesshëm

1. Kur humbja e pjesshme ose dëmtimi i një artikulli si (bagazhe, automjete) zbulohet ose supozohet nga transportuesi, ose pretendohet nga pronari i bagazhit, transportuesi pa vonesë, dhe nëse është e mundur në praninë e pronarit të bagazhit, harton një raport që tregon, sipas natyrës së humbjes ose dëmtimit, gjendjen e artikullit dhe, për aq sa është e mundur, shkallën e humbjes ose dëmtimit, shkaku dhe kohën e shfaqjes së tij.

2. Një kopje e raportit i jepet pa pagesë pronarit të bagazhit.

3. Nëse pronari i bagazhit nuk pranon përmbajtjen e raportit, ai kërkon shqyrtimin nga një ekspert i caktuar nga palët në kontratën e transportit ose ankohet në gjykatë. Procedura që ndiqet rregullohet nga ligjet dhe rregullat në fuqi.

Neni 43

Pretendimet

1. Pretendimet në lidhje me përgjegjësinë e transportuesit në rast të vdekjes ose lëndimit personal të udhëtarëve i drejtohen me shkrim transportuesit kundër të cilit ngrihet padi. Në rastin e një transporti të drejtuar nga një kontratë e vetme dhe të kryer nga transportues të njëpasnjëshëm,

pretendimet mund t'i drejtohen gjithashtu transportuesit të parë ose të fundit, si dhe transportuesit që ka vendin e tij kryesor të biznesit ose agjencisë që ka lidhur kontratën e transportit.

2. Pretendimet e tjera në lidhje me kontratën e transportit i drejtohen me shkrim transportuesit të specifikuar në pikat 2 dhe 3, të nenit 44.

3. Dokumentet që personi paditës mendon se janë të përshtatshme të paraqesë bashkëngjitur me kërkesën, paraqiten në original ose në kopje të vërtetuara sipas kërkesave të transportuesit. Pas zgjidhjes së kërkesës, transportuesi mund të kërkojë dorëzimin e biletës, kuponin e regjistrimit të bagazhit dhe kuponin e transportit.

Neni 44

Transportuesit kundër të cilëve mund të ngrihet padi

1. Një padi e bazuar në përgjegjësinë e transportuesit në rast të vdekjes ose lëndimit personal të udhëtarëve ngrihet vetëm kundër transportuesit, i cili është përgjegjës në përputhje me nenin 16, pika 5.

2. Në varësi të paragrafit 4, padi të tjera të ngritura nga udhëtarët në bazë të kontratës së transportit ngrihen vetëm kundër transportuesit të parë, transportuesit të fundit ose transportuesit që ka kryer pjesën e transportit në të cilën ka ndodhur ngjarja që ka shkaktuar procedimin.

3. Kur në rastin e transportit të kryer nga transportues të njëpasnjëshëm, transportuesi që duhet të dorëzojë bagazhin ose mjetin është futur me pëlqimin e tij në kuponin e regjistrimit të bagazhit ose në kuponin e transportit, kundër tij ngrihet padi në përputhje me paragrafin 2 edhe nëse nuk e ka marrë bagazhin ose mjetin.

4. Padia për rikuperimin e një shume të paguar në bazë të kontratës së transportit ngrihet kundër transportuesit që e ka mbledhur atë shumë ose kundër transportuesit në emër të të cilit është mbledhur.

5. Një padi mund të ngrihet kundër një transportuesi të ndryshëm nga ata të specifikuar në paragrafët 2 dhe 4, kur ngrihet me anë të kundërpadisë ose me përjashtim në procedurat në lidhje me një pretendim kryesor të bazuar në të njëjtën kontratë transporti.



6. Në masën që këto rregulla zbatohen për transportuesin zëvendësues, një padi ngrihet edhe kundër tij.

7. Nëse paditësi ka një zgjedhje midis disa transportuesve, e drejta e tij për të zgjedhur shuhet sapo të ngrejë padi kundër njërit prej tyre; kjo zbatohet gjithashtu nëse paditësi ka një zgjedhje midis një ose më shumë transportuesve dhe një transportuesi zëvendësues.

Neni 45

Shuarja e së drejtës së veprimit në rast vdekjeje ose dëmtimi personal

1. Në rast të vdekjes ose dëmtimit personal të udhëtarëve, çdo e drejtë veprimi nga paditësi shuhet nëse nuk bëhet njoftimi për aksidentin brenda 12 muaj pasi ai ka marrë dijeni për humbjen ose dëmtimin, tek një prej transportuesve të cilit i drejtohet një kërkesë, në përputhje me nenin 43, pika 1. Kur paditësi e njofton transportuesin me gojë për aksidentin, transportuesi duhet t'i japë atij një konfirmim të një njoftimi të tillë gojor.

2. Megjithatë, e drejta e veprimit nuk shuhet nëse:

a) brenda periudhës së parashikuar në paragrafin 1, paditësi i është drejtuar me një pretendim njërit prej transportuesve të përcaktuar në nenin 43, pika 1;

b) brenda periudhës së parashikuar në paragrafin 1, transportuesi i cili është përgjegjës ka mësuar për aksidentin e udhëtarit në ndonjë mënyrë tjetër;

c) njoftimi për aksidentin nuk është dhënë, ose është dhënë me vonesë, si rezultat i rrethanave që nuk i atribuohen paditësit;

ç) paditësi provon se aksidenti është shkaktuar nga faji i transportuesit.

Neni 46

Shuarja e së drejtës së veprimit në rast humbjeje apo dëmtimi të bagazheve

1. Pranimi i bagazhit nga pronari shuan të gjitha të drejtat e veprimit kundër transportuesit që rrjedhin nga kontrata e transportit në rast të humbjes së pjesshme, dëmtimit ose vonesës në dorëzim.

2. Megjithatë, e drejta e veprimit nuk shuhet:

a) në rast të humbjes ose dëmtimit të pjesshëm, nëse:

1. humbja ose dëmtimi është konstatuar në përputhje me nenin 42 para pranimit të bagazhit nga pronari i bagazhit;

2. konstatimi i cili duhet të ishte kryer, në përputhje me nenin 42, është hequr vetëm për fajin e transportuesit;

b) në rast humbjeje ose dëmtimi që nuk është i dukshëm, ekzistenca e të cilit konstatohet pas pranimit të bagazhit nga pronari, nëse ai:

1. kërkon konstatimin në përputhje me nenin 42, menjëherë pas zbulimit të humbjes ose dëmtimit dhe jo më vonë se tre ditë pas pranimit të bagazhit; dhe

2. përveç kësaj, vërteton se humbja ose dëmtimi ka ndodhur ndërmjet kohës së marrjes në dorëzim nga transportuesi dhe kohës së dorëzimit;

c) në rast vonese në dorëzim, nëse pronari i bagazhit, brenda njëzet e një ditësh, ka kërkuar të drejtat e tij kundër njërit prej transportuesve të specifikuar në nenin 44, pika 3;

ç) nëse pronari i bagazhit provon se humbja ose dëmtimi është shkaktuar nga faji i transportuesit.

Neni 47

Kufizimi i veprimeve

1. Periudha e kufizimit të veprimeve për dëmshpërblim, bazuar në përgjegjësinë e transportuesit në rast të vdekjes ose dëmtimit personal të udhëtarëve, do të jetë:

a) në rastin e një udhëtarit, tre vjet nga e nesërmja e aksidentit;

b) në rastin e personave të tjerë që kanë të drejtë ligjore për kërkimin e dëmshpërblimit, tre vjet nga e nesërmja e vdekjes së udhëtarit, me një maksimum prej pesë vjetësh nga e nesërmja e aksidentit.

2. Afati i parashkrimit për veprimet e tjera që rrjedhin nga kontrata e transportit është një vit. Megjithatë, periudha e parashkrimit do të jetë dy vjet në rastin e një veprimi për humbje ose dëmtim që rezulton nga një veprim ose mosveprim i kryer ose me qëllim për të shkaktuar një humbje ose dëmtim të tillë, ose me pakujdesi dhe me dijeninë se një humbje ose dëmtim i tillë ka të ngjarë rezultat.

3. Periudha e kufizimit të parashikuar në paragrafin 2 do të zbatohet për veprimet:

a) për kompensimin e humbjes totale, nga dita e katërmëdhjetë pas skadimit të periudhës kohore të parashikuar në nenin 13, pika 3;



b) për kompensim për humbje të pjesshme, dëmtim ose vonesë në dorëzim, nga dita kur ka ndodhur dorëzimi;

c) në të gjitha rastet e tjera që kanë të bëjnë me transportin e udhëtarëve, nga dita e skadimit të vlefshmërisë së biletës.

Dita e treguar për fillimin e periudhës së parashkrimit nuk do të përfshihet në periudhë.

4. Përndryshe, pezullimi dhe ndërprerja e periudhave të parashkrimit rregullohet nga ligjet në fuqi.

TITULLI VI MARRËDHËNIET MIDIS TRANSPORTUESVE

Neni 48

Ndarja e tarifës së transportit

1. Çdo transportues që mbledh një tarifë transporti ju pagan transportuesve përkatës pjesën e tyre të tarifës. Mënyrat e pagesës caktohen me marrëveshje ndërmjet transportuesve.

2. Për marrëdhëniet ndërmjet transportuesve të njëpasnjëshëm zbatohen gjithashtu neni 1, pika 3 dhe neni 9, pika 3.

Neni 49

E drejta e rekursit

1. Një transportues i cili ka paguar kompensim në përputhje me këto rregulla ka të drejtën e rekursit kundër transportuesve që kanë marrë pjesë në transport, në përputhje me dispozitat e mëposhtme:

a) transportuesi që ka shkaktuar humbjen ose dëmtimin është i vetëm përgjegjës për të;

b) kur humbja ose dëmtimi është shkaktuar nga disa transportues, secili do të jetë përgjegjës për humbjen ose dëmin që ka shkaktuar; nëse një dallim i tillë është i pamundur, kompensimi do të ndahet ndërmjet tyre në përputhje me shkronjën “c”;

c) nëse nuk mund të vërtetohet se cili nga transportuesit ka shkaktuar humbjen ose dëmin, kompensimi do të ndahet midis të gjithë transportuesve që kanë marrë pjesë në transport, përveç atyre që provojnë se humbja ose dëmi nuk është shkaktuar prej tyre; një ndarje e tillë do të jetë në përpjesëtim me pjesën e tyre përkatëse të tarifës së transportit.

2. Në rastin e falimentimit të secilit prej këtyre transportuesve, pjesa e papaguar që i takon atij do të ndahet midis të gjithë transportuesve të tjerë që kanë marrë pjesë në transport, në përpjesëtim me pjesën e tyre përkatëse të tarifës së transportit.

Neni 50

Procedura e rekursit

1. Nëse një transportues ushtron të drejtën e rekursit kundër një transportuesi tjetër sipas nenit 49 dhe kompensimi është përcaktuar nga një gjykatë, transportuesi kundër të cilit ushtrohet e drejta për rekurs nuk mund të kundërshtojë vlefshmërinë e pagesës. Gjykata i jep mundësi transportuesit nëpërmjet njoftimit dhe kohës së nevojshme për ndërhyrje në procedurë.

2. Transportuesi që ushtron të drejtën e tij të rekursit duhet të paraqesë kërkesën e tij në të njëjtën procedurë kundër të gjithë transportuesve me të cilët ai nuk ka arritur marrëveshje, në rast të kundërt ai humbet të drejtën e tij të rekursit.

3. Gjykata jep vendimin e saj në të njëjtin vendim për të gjitha kërkesat për rekurs të paraqitura para saj.

4. Transportuesi që dëshiron të zbatojë të drejtën e tij të rekursit mund të ngrejë padinë e tij në gjykatën në territorin e të cilit njëri nga transportuesit pjesëmarrës në transport ka vendin kryesor të biznesit të tij ose degën, ose agjencinë që ka përfunduar kontrata e transportit.

5. Kur padia ngrihet kundër disa transportuesve, transportuesi paditës ka të drejtë të zgjedhë gjykatën në të cilin ngre procedimin midis atyre që kanë kompetencë sipas paragrafit 4.

6. Procedurat e rekursit nuk mund të bashkohen me procedurat për dëmshpërblim të marra nga personi që ka të drejtë ligjore dëmshpërblimi sipas kontratës së transportit.

Neni 51

Marrëveshjet në lidhje me rekursin

Transportuesit mund të lidhin marrëveshje që shmangin nenet 48 dhe 49.



ANEKSI III

INFORMACION MINIMAL QË DUHET TË SIGUROHET NGA SIPËRMARRJET HEKURUDHORE DHE/OSE NGA SHITËSIT E BILETAVE

1. Informacion para udhëtimit

- Kushtet e përgjithshme të zbatueshme për kontratën;
- Oraret dhe kushtet për udhëtimin më të shpejtë;
- Oraret dhe kushtet për të gjitha tarifat e disponueshme, duke theksuar tarifat më të ulëta;
- Aksesueshmëria, kushtet e aksesit dhe disponueshmëria në bordin e objekteve për personat me aftësi të kufizuara dhe personat me lëvizshmëri të reduktuar;
- Disponueshmëria e kapacitetit dhe kushtet e aksesit për biçikletat;
- Disponueshmëria e sediljeve në klasën e parë dhe të dytë, si dhe vagonët e gjumit;
- Ndërprerje dhe vonesa (të planifikuara dhe në kohë reale);
- Disponueshmëria e objekteve në tren, duke përfshirë *wi-fi* dhe tualetet, dhe e shërbimeve në tren, duke përfshirë ndihmën me të cilën udhëtarët ofrohen nga stafi;
- Informacioni përpara blerjes, nëse bileta ose biletat përbëjnë një biletë;
- Procedurat për rikuperimin e bagazheve të humbura;
- Procedurat për paraqitjen e ankesave.

2. Informacion gjatë udhëtimit

- Shërbime dhe lehtësira në tren, duke përfshirë *wi-fi*;
- Stacioni tjetër;
- Ndërprerje dhe vonesa (të planifikuara dhe në kohë reale);
- Shërbimet kryesore lidhëse;
- Çështjet e mbrojtjes dhe sigurisë.

3. Operacionet në lidhje me sistemet e rezervimeve

- Kërkesat për disponueshmërinë e shërbimeve të transportit hekurudhor, duke përfshirë tarifat e aplikueshme;
- Kërkesat për rezervimin e shërbimeve të transportit hekurudhor;
- Kërkesat për anulim të pjesshëm ose të plotë të një rezervimi.

ANEKSI IV

STANDARDET MINIMALE TË CILËSISË SË SHËRBIMIT

Informacion dhe bileta

Përpikëria e shërbimeve dhe parimet e përgjithshme për të përballuar ndërprerjet e shërbimeve.

Vonesat:

- i. vonesa mesatare e përgjithshme e shërbimeve si përqindje për kategori shërbimi (në distanca të gjata, rajonale dhe urbane/periferike);
 - ii. përqindja e vonesave të shkaktuara nga rrethanat e përmendura në pikën 10, të nenit 20 të udhëzimit;
 - iii. përqindja e shërbimeve të vonuara në nisje;
 - iv. përqindja e shërbimeve të vonuara në mbërritje:
- përqindja e vonesave më pak se 60 minuta;
 - përqindja e vonesave 60–119 minuta;
 - përqindja e vonesave prej 120 minutash ose më shumë.

Anulimet e shërbimeve:

- i. anulimi i shërbimeve si përqindje për kategori shërbimi (ndërkombëtar, vendës në distanca të gjata, rajonale dhe urbane/periferike);
- ii. anulimi i shërbimeve si përqindje për kategori shërbimi (ndërkombëtar, vendës në distanca të gjata, rajonale dhe urbane/periferike) të shkaktuara nga rrethanat e përmendura në pikën 10, të nenit 20 të udhëzimit.

Pastërtia e mjeteve hekurudhore dhe objekteve të stacioneve (kontrolli i cilësisë së ajrit dhe temperaturës në vagonë, higjiena e objekteve sanitare etj.).

Anketa e cilësisë së shërbimeve të klientit.

Trajtimi i ankesave, rimbursimet dhe kompensimi për mospërputhje me standardet e cilësisë së shërbimit.

Ndihma e ofruar për personat me aftësi të kufizuara dhe personat me lëvizshmëri të reduktuar, dhe diskutime në lidhje me këtë ndihmë me organizata përfaqësuese dhe, sipas rastit, përfaqësues të personave me aftësi të kufizuara dhe personave me lëvizshmëri të reduktuar.



UDHËZIM

Nr. 33, datë 20.12.2023

**PËR MËNYRËN E ZBATIMIT TË
VENDIMIT TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE NR. 161, DATË 21.3.2018,
“PËR PAGESËN E SË ARDHURËS NGA
PAPUNËSIA”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe pikës 24, të vendimit nr. 161, datë 21.3.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për pagesën e së ardhurës nga papunësia”, i ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Në zbatim të pikës 2 të vendimit nr. 161, datë 21.3.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për pagesën e së ardhurës nga papunësia”, të ndryshuar, përfitojnë të ardhura nga papunësia personat të cilët plotësojnë kushtet e mëposhtme:

a) të kenë kontribuar në sigurimin shoqëror si punëmarrës për një periudhë të paktën 12-mujore, për çdo rast përfitimi;

b) të jenë regjistruar si punëkërkues të papunë pranë strukturës vendore përkatëse të punësimit;

c) të kenë paraqitur kërkesën dhe dokumentacionin sipas pikës 6, të vendimit nr. 161, datë 21.3.2018, të ndryshuar për të përfutur të ardhurën nga papunësia, pranë strukturës vendore përkatëse brenda 60 ditëve kalendarike nga data e shkëputjes së marrëdhënies së punësimit me punëdhënësin.

2. Kërkuesit muk përfitojnë pagesën e së ardhurës nga papunësia nëse nuk plotësojnë kushtin e parashikuar në shkronjën “c”, të pikës 1, me përjashtim të rasteve të paaftësisë së përkohshme për punë, paaftësi e vërtetuar me raport mjekësor ose dokumente shoqëruese, që kanë qenë të shtruar në spital (fletëhyrje dhe fletëdalje nga spitali).

3. Kategoritë përfituese të pagesës së të ardhurës nga papunësia janë:

a) Të gjithë personat të cilët kanë kontribuar si punëmarrës në sigurimet shoqërore për një periudhë të paktën 12-mujore gjithsej brenda 24 muajve të fundit, me kusht që 2 muajt e fundit të jenë pa ndërprerje, për çdo rast përfitimi;

b) Gratë, të cilat përfundojnë trajtimin me të ardhurën e barrë lindjes dhe në momentin që

kthehen në vendin e punës iu ndërpritet marrëdhënia individuale e punës;

c) Burrat, të cilët përfundojnë trajtimin e përfitimit të përkujdesjes për fëmijën, por jo më parë se 63 ditë pas lindjes së fëmijës dhe në momentin që kthehen në vendin e punës, iu ndërpritet marrëdhënia individuale e punës;

ç) Personat, të cilët janë shkëputur nga puna për arsye të përfitimit të paaftësisë së përkohshme dhe mbas mbarimit të kësaj periudhe, në momentin që kthehen në vendin e punës, iu ndërpritet marrëdhënia individuale e punës;

d) Ushtarakët e liruar nga detyra, të cilët nuk përfitojnë të ardhura nga akte të tjera ligjore dhe nënligjore si pension të parakohshëm suplementar ose pension pleqërie;

e) Shtetasit e huaj, që jetojnë në Shqipëri, trajtohen në kushte të barabarta me shtetasit shqiptarë, sipas pikës 2 shkronja “a”, për përfitimin e të ardhurës nga papunësia.

4. Për rastet e përsëritura të përfitimit, kur personi paraqet kërkesën më shumë se një herë, sipas shkronjave “a”, “b”, “c”, “ç” dhe “d” të pikës 4 të vendimit nr. 161, datë 21.3.2018, të ndryshuar, trajtohen duke llogaritur periudhën e kontributeve si punëmarrës, duke filluar nga përfitimi i fundit.

5. Në zbatim të pikës 6, shkronja “ç” të vendimit nr. 161, datë 21.3.2018, të ndryshuar, përfituesi duhet të sjellë për çdo vit të ri akademik vërtetimin për fëmijët që ndjekin shkollën.

6. Pagesën e së ardhurës nga papunësia nuk e përfitojnë personat të cilët:

a) janë punëdhënëses ose të vetëpunësuar në qytet dhe fshat;

b) rezultojnë me aktivitet të pambyllur në sistemin tatimor;

c) janë duke vuajtur dënim me heqje lirie;

ç) largohen nga puna me dëshirën e tyre;

d) janë larguar jashtë shtetit për arsye të ndryshme dhe nuk plotësojnë detyrimin sipas pikës 8 shkronja “c” të vendimit nr. 161, datë 21.3.2018, të ndryshuar.

Verifikimet kryhen nga çdo strukturë vendore e punësimit në momentin e administrimit të kërkesës për përfitim të pagesës së të ardhurës nga papunësia.

7. Në të gjitha rastet e përfitimit të së ardhurës nga papunësia, të ndërprera për arsye punësimi të përkohshëm, personi ka të drejtë të marrë pjesën e ngelur, por me kusht që rifillimi i periudhës së përfitimit të pagesës së të ardhurës nga papunësia, të



jetë brenda 24 muajve nga shkëputja për herë të parë nga puna dhe periudha e përfitimit të mos jetë më shumë se 3 muaj për personat, që kanë të paktën 1 vit punë, 6 muaj për personat që kanë të paktën 3 vjet punë, 9 muaj për personat që kanë të paktën 5 vjet punë, dhe 12 muaj për personat që kanë mbi 10 vjet punë.

Në rastet e ndërprerjes të së ardhurës nga papunësia, për arsye të përfitimit të lejes së lindjes, pjesa e ngelur, në të gjitha rastet e përfitimit, merret pas përfundimit të lejes së lindjes.

8. Kategoritë përfituese të së ardhurës nga papunësia, të cilët e ndërpresin pagesën për shkak punësimi, aftësimi apo leje lindjeje, apo raste të tjera të përligjura, rikthehen në skemë për përfitimin e ngelur, me nivelin e së ardhurës nga papunësia në momentin e rikthimit.

9. Përfituesit që ndjekin kurse kualifikimi dhe rikualifikimi, përfitojnë pagesën e së ardhurës nga papunësia gjatë kohës së zhvillimit të kurseve, në rast se nuk paguhen nga ndonjë burim tjetër për këtë periudhë.

10. Rastet, kur përfituesi është i justifikuar për mosparaqitje, janë:

a) sëmundje e vërtetuar me dokumente fletështrimi dhe fletëdaljeje nga spitali;

b) vdekja e një pjesëtari të familjes, e vërtetuar me certifikatë vdekjeje;

c) ndalimi nga organet e drejtësisë, e vërtetuar me dokumentacionin përkatës.

11. Në të gjitha rastet e përcaktuara në pikën 8 të vendimit nr. 161, datë 21.3.2018, të ndryshuar, periudha e ngelur nuk përfitohet.

12. Udhëzimi nr. 17, datë 14.5.2018, “Për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 161, datë 21.3.2018, “Për pagesën e së ardhurës nga papunësia”, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
Ervin Mete

URDHËR

Nr. 65, datë 20.12.2023

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”; të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik” dhe të udhëzimit nr. 4, datë 29.1.2020, “Për delegimin e të drejtave dhe detyrave në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit, për nisjen dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit, për blerjet me vlera të vogla apo direkte, te drejtori i Drejtorisë Juridike, znj. Alisa Basha.

2. Kompetenca e deleguar, sipas pikës 1 të këtij urdhri, do të ushtrohet nga data e hyrjes në fuqi të këtij urdhri deri më datë 31.1.2024.

3. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri drejtori i Drejtorisë Juridike, znj. Alisa Basha.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Adelajda Roka

NJOFTIM

Nr. 18885, datë 22.12.2023

MBI HYRJEN NË FUQI TË NJË MARRËVESHJEJE DYPALËSHE ME BASHKIMIN EVROPIAN

Marrëveshja me Bashkimin Evropian për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në Programin e Bashkimit të Evropës Digjitalë, për periudhën 2021–2027, ka hyrë në fuqi më datë 7.12.2023.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM I
MINISTRISË PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME
Gazmend Turdiu



VENDIM

Nr. 60, datë 20.11.2023

NË EMËR TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Elsa Toska	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;
Genti Ibrahim	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare,

me sekretare Belma Lleshi, në datën 20.11.2023 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 22 (A) 2023 të Regjistrat Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Agim Elezi, përfaqësuar nga avokat Sokol Gjini, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Luljeta Hysolli, përfaqësuar nga avokat Ilir Dode, me prokurë. Margarita Kolldani (Elezi), Migena Merjo (Elezi), Thëllënza Mana (Elezi), Marinela Elezi, Romina Elezi, përfaqësuar nga avokat Qani Hasa, me prokurë.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 221 (13-2014-1621), datë 13.3.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan; nr. 59/10-2014-1954, datë 27.5.2014, të Gjykatës së Apelit Durrës; nr. 00-2022-3489, datë 23.11.2022, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Dërgimi i çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 18/1, 41, 42, 43, 44, 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Fiona Papajorgji, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuarit, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, Luljeta Hysolli, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës dhe të subjekteve të interesuara, Margarita Kolldani (Elezi), Migena Merjo (Elezi), Thëllënza Mana (Elezi), Marinela Elezi dhe Romina Elezi, që kanë kërkuar pranimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuari Agim Elezi, në cilësinë e ortakut të vetëm, në datën 9.11.2002 ka themeluar shoqërinë tregtare “Amal” sh.p.k., me objekt të veprimtarisë, ndër të tjera, shfrytëzimin e centraleve elektrike dhe të rrjetit elektrik, si dhe ndërtimin e veprave elektroenergjetike. Me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 90, datë 13.2.2003 (*VKM nr. 90/2003*) është vendosur fillimi i procedurës për dhënie me koncesion të hidrocentralit të Xhyrës në favor të kësaj shoqërie. Në vijim, me vendimin nr. 486, datë 10.7.2003 (*VKM nr. 486/2003*), shoqëria “Amal” sh.p.k. ka marrë me koncesion hidrocentralin, si dhe nënshkruar marrëveshjen e koncesionit me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ministrinë e Industrisë dhe të Energjetikës. Po kështu, në datën 22.12.2006, kërkuari ka themeluar si ortak i vetëm edhe shoqërinë tregtare “R.” sh.p.k., me objekt të veprimtarisë, ndër të tjera, projektimin, ndërtimin dhe shfrytëzimin e hidrocentraleve dhe të termocentraleve.

2. Përmes kontratave noteriale nr. 2056 rep. dhe nr. 218 kol., datë 27.5.2004 (*kontrata nr. 2056/218/2004*), nr. 3041 rep. dhe nr. 684 kol., datë 27.7.2006 (*kontrata nr. 3041/684/2006*), nr. 504 rep. dhe nr. 142 kol., datë 23.1.2007 (*kontrata nr. 504/142/2007*), kërkuari i ka shitur subjektit të interesuar Luljeta Hysolli 100% të kuotave të kësaj shoqërie përkundrejt çmimit 1.000 lekë për secilën kuotë. Po në datën 23.1.2007 kërkuari dhe bashkëshortja e tij, shtetasja M. E., kanë nënshkruar deklaratën noteriale nr. 506 rep. dhe nr. 144/2 kol. (*deklarata noteriale*), në të cilën kanë



deklaruar se në bazë të atyre kontratave kanë përfituar në total shumë prej 20.000,000 lekësh nga subjekti i interesuar Luljeta Hysolli, nga shitja e pjesëve të kapitalit të shoqërisë. Gjithashtu, ata kanë deklaruar se “...nuk kanë pretendime edhe për pasuri të paluajtshme që është në funksion të Hidrocentralit të Xhyrës dhe në pronësi të shoqërisë “Amal” edhe nëse sipas ligjeve të mëvonshme kjo pasuri do të regjistrohet në ZVRPP ata kanë detyrimin të bëjnë shitjen e kësaj prone pa kundërshtpërblim, pasi shitja e kuotave të shoqërisë ka në vlerë edhe pasurinë e paluajtshme truall apo tokë arë dhe çdo pasuri tjetër që i takon shoqërisë”. Pas nënshkrimit të kontratave të mësipërme, mes kërkuessit dhe subjektit të interesuar Luljeta Hysolli kanë lindur mosmarrëveshje, për të cilat palët i janë drejtuar gjykatës në disa procese.

3. Subjekti i interesuar, Luljeta Hysolli (tashmë ortake e vetme e shoqërisë “Amal” sh.p.k.), ka nisur procesin në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan, ku ka paditur kërkuessin dhe bashkëshorten e tij M.E., duke kërkuar konstatimin e pavlefshmërisë së veprimit juridik (të deklaratës noteriale) dhe kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme nëpërmjet detyrimit të tyre solidarisht për të kthyer shumë prej 19.900.000 lekësh, me pretendimin se ata nuk i kanë kaluar pronësinë e asnjë pasurie të paluajtshme në funksion të hidrocentralit. Po kështu, në këtë padi është kërkuar edhe marrja e masës për sigurimin (*procesi i parë gjyqësor*).

4. Me vendimin nr. 1658, datë 25.7.2011, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka vendosur: *“Pranimin e padisë. Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të kontratës së shitjes mes palëve ndërgjyqëse nëpërmjet deklaratës noteriale nr. 506 rep., nr. 144 kol., datë 23.1.2007 [...] dhe kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme duke detyruar të paditurit Agim Elezi dhe M.E. t’i paguajnë solidarisht paditëses Luljeta Hysolli shumë 19.900.000 lekë. Ligjërimin e sigurimit të padisë vendosur me vendimin, datë 6.6.2010 me urdhërimin e ndalimin e transferimit të së drejtës së pronësisë së kuotave të zotëruara nga Agim Elezi si dhe të asetëve të zotëruara nga Agim Elezi në “R.” sh.p.k. dhe dërgimin e një kopje të vendimit Qendrës Kombëtare të Regjistrimit për shënimet e ndalimit në regjistrin tregtar.”* Kundër këtij vendimi kanë paraqitur ankim kërkuessi dhe bashkëshortja e tij.

5. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 10-2014-95/49, datë 16.1.2014, ka vendosur:

“Lënien në fuqi të vendimit nr. 1658, datë 25.7.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.” Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs kërkuessi.

6. Për sa i përket kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimeve të gjykatave të faktit, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 79, datë 2.3.2015, ka vendosur: *“Pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 1658, datë 25.7.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan i lënë në fuqi me vendimin nr. 95/49, datë 16.1.2014, të Gjykatës së Apelit Durrës.”* Në lidhje me themelin e çështjes, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-2260 (337), datë 5.10.2022, në dhomën e këshillimit, ka vendosur: *“Lënien në fuqi të vendimit nr. 10-2014-95/49, datë 16.1.2014, të Gjykatës së Apelit Durrës. Revokimin e vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr. 79, datë 2.3.2015, Për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 1658, datë 25.7.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan i lënë në fuqi me vendimin nr. 95/49, datë 16.1.2014, të Gjykatës së Apelit Durrës.”*

7. Ky proces gjyqësor është kundërshtuar nga kërkuessi në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*) në datën 4.2.2023, i cili ka pretenduar, ndër të tjera, cenimin e parimit të sigurisë juridike dhe standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor. Kolegji i Gjykatës, me vendimin nr. 73, datë 11.4.2023, ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare. Lidhur me pretendimin e kërkuessit se vendimi i Gjykatës së Lartë ka cenuar parimin e sigurisë juridike, pasi kjo gjykatë nuk ka ndjekur praktikën e Kolegjeve të Bashkuara, Kolegji ka vlerësuar se ai është haptazi i pabazuar, pasi nuk rezulton që Gjykata e Lartë t’i ketë dhënë zgjidhje çështjes së kërkuessit në kundërshtim me vendimet unifikuese. Për sa i përket pretendimit për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit, pasi Gjykata e Lartë nuk ka evidentuar të drejtat e pronësisë së kërkuessit që i burojnë nga kontrata e koncesionit, si dhe vendimi i saj është i paqartë në pjesën urdhëruese, Kolegji ka vlerësuar se edhe ai pretendim është haptazi i pabazuar, pasi Gjykata e Lartë i ka marrë në shqyrtim shkaqet e paraqitura në rekurs dhe u ka dhënë përgjigje shteruese atyre, duke plotësuar kështu kërkesat për respektimin e këtij standardi.

8. Në datën 4.3.2014, kërkuessi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan me kërkesë për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për vendimin civil nr. 1658, datë 25.7.2011, të Gjykatës së



Rrethit Gjyqësor Elbasan, sipas kërkesave të nenit 510, shkronja “d”, të Kodit të Procedurës Civile (KPC), vetëm për sa i përket pikës së parë të vendimit, në të cilin gjykata është shprehur për kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme. Kërkuesi ka pretenduar se vendimi gjyqësor përbën titull ekzekutiv dhe duhet të ekzekutohet në rrugë përmbartimore, pasi në këtë vendim gjykata ka urdhëruar palët që të kthehen në gjendjen e mëparshme, pra atij t'i kthehet objekti i Hidrocentralit të Xhyrës (*procesi i dytë gjyqësor*).

9. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. 221 (13-2014-1621), datë 13.3.2014, ka vendosur: “*Rrëzimin e kërkesës së kërkuesit Agim Elezi për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për vendimin nr. 1658, datë 25.7.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, si të pabazuar në prova dhe në ligj.*”.

10. Me vendimin nr. 59/10-2014-1954, datë 27.5.2014, Gjykata e Apelit Durrës ka vendosur: “*Lënien në fuqi të vendimit nr. 221 (13-2014-1621), datë 13.3.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.*”.

11. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-3489, datë 23.11.2022, ka vendosur: “*Mospranimin e rekursit të paraqitur nga pala kërkuese në këtë gjykim, Agim Elezi, kundër vendimit nr. 59/10-2014-1954, datë 27.5.2014, të Gjykatës së Apelit Durrës.*”, me argumentin se nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 472 të KPC-së.

12. Në datën 23.3.2023 (*sipas shënimit të shërbimit postar*) kërkuesi i është drejtuar përsëri Gjykatës me kërkesë, e cila është plotësuar në datën 7.4.2023 sipas objektit. Kolegji i Gjykatës në datën 8.6.2023, me shumicë votash, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në Mbledhjen e Gjyqtarëve, e cila në datën 26.6.2023 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve, duke përcaktuar edhe subjektet e interesuara që do të thirreshin në gjykim. Për njërin prej tyre (M.E.- bashkëshortja e kërkuesit, në cilësinë e palës ndërgjyqëse në vendimet për shqyrtimin e çështjes në themel), Gjykata është njoftuar nga kërkuesi se ajo ka ndërruar jetë. Në vijim, trashëgimtarët e subjektit të interesuar M.E. kanë paraqitur në Gjykatë vendimin për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore të datës 22.7.2019 të Dhomës Kombëtare të Noterisë, Tiranë, sipas të cilit rezulton se shtetasja M.E. ka ndërruar jetë në datën 2.6.2019.

Në këto kushte, Mbledhja e Gjyqtarëve, në përputhje me nenin 1, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000 dhe nenin 199 të KPC-së, me vendimin e datës 13.9.2023, pasi ka konstatuar radhën e trashëgimtarëve ligjorë të së ndjerës M.E., ka vendosur të thërrasë në këtë gjykim, në cilësinë e subjekteve të interesuara, vajzat e saj, shtetaset Margarita Kolldani (Elezi), Migena Merjo (Elezi), Thëllënza Mana (Elezi), Marinela Elezi, Romina Elezi.

13. Në datën 14.11.2023 Mbledhja e Gjyqtarëve, në zbatim të neneve 37, pikat 1 dhe 2 dhe 36, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së kërkuesit për përjashtimin e dy anëtarëve të Gjykatës nga shqyrtimi i çështjes.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

14. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimi i Gjykatës së Lartë i ka cenuar:

14.1. *Të drejtën për proces të rregullt ligjor* në drejtim të:

14.1.1. *Parimit të sigurisë juridike dhe pritshmërive të ligjshme*, pasi Gjykata e Lartë nuk ka zbatuar dhe ka anashkaluar detyrimin e vendosur me vendimin gjyqësor të formës së prerë, i cili ka urdhëruar kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme, çka nënkupton se kërkuesit duhet t'i kthehet posedimi i objektit të hidrocentralit. Kërkuesi kishte pritshmëri të ligjshme se urdhri i ekzekutimit do të lëshohej nga kjo gjykatë, bazuar në vendimin nr. 00-2022-2260 (337), datë 5.10.2022 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë. Në këtë mënyrë, vendimi objekt kundërshtimi ka cenuar edhe parimin e shtetit të së drejtës, ligjshmërisë dhe hierarkisë së akteve normative, pasi Gjykata e Lartë qëllimisht ka deformuar ligjin për titujt ekzekutivë.

14.1.2. *Parimit të gjykatës së caktuar me ligj*, pasi Gjykata e Lartë ka dalë jashtë kufijve të shqyrtimit të çështjes dhe objektit të kërkesës kur ka argumentuar se vendimet e dhëna nga gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit nuk janë në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Civil ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Kjo gjykatë, megjithëse ka detyrimin ligjor të zgjidhë mosmarrëveshjen civile, nuk ka dhënë asnjë



argument se cili është mjeti ligjor që duhet të përdorë kërkuesi për të realizuar të drejtën e tij.

14.1.3. *Standardit të arsyetimit të vendimit*, pasi Gjykata e Lartë nuk ka arsyetuar me hollësi se përse vendimet e formës së prerë nuk janë tituj ekzekutivë dhe arsyet se përse nuk lëshon urdhrin e ekzekutimit. Vendimi nuk plotëson kërkesat kushtetuese dhe standardet e vendosura nga Gjykata dhe Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut për arsyetimin e vendimeve.

14.1.4. *Parimit të paanshmërisë*, pasi Gjykata e Lartë nuk ka marrë në shqyrtim dhe nuk u ka kthyer përgjigje pretendimeve dhe kërtimeve të tij, duke u treguar hapur e njëanshme.

14.2. *Parimin e barazisë përpara ligjit*, të garantuar nga neni 18, pika 1, i Kushtetutës.

14.3. *Të drejtën e pronës*, pasi Gjykata e Lartë, duke mos pranuar lëshimin e urdhrin të ekzekutimit të një vendimi të formës së prerë, i ka shkaktuar atij një dëm të madh ekonomik.

15. ***Subjekti i interesuar, Luljeta Hysolli***, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar:

15.1. Pretendimet e kërkuesit janë të pabazuara, pasi ai nuk mund të kërkonte lëshimin e urdhrin të ekzekutimit për një vendim në të cilin është në pozitën e debitorit dhe jo të kreditorit. Nëpërmjet këtij vendimi gjykatat nuk i kanë njohur asnjë të drejtë kërkuesit për kuotat e shoqërisë që administron hidrocentralin. Marrëveshja e nënshkruar nëpërmjet deklaratës noteriale është konstatuar nga gjykatat si e pavlefshme, pasi kërkuesi nuk e ka pasur asnjëherë pronësinë për tokën ose hidrocentralin, për aq kohë sa ato janë në pronësi të shtetit. E ndjera M.E. ka qenë në dijeni të plotë të të gjitha veprimeve juridike të kryera për shitjen e kuotave të shoqërisë dhe deklaratës noteriale. Bazuar në vendimet gjyqësore të themelit të çështjes, kërkuesi dhe trashëgimtarët e së ndjerës M.E. kanë detyrimin për të paguar një shumë monetare. Për më tepër, kërkuesi nuk ka informuar Gjykatën për rrethanën e ndarjes nga jeta të subjektit të interesuar në këtë gjykim.

16. ***Subjektet e interesuara, Margarita Kollani (Elezi), Migena Merjo (Elezi), Thëllënza Mana (Elezi), Marinela Elezi, Romina Elezi***, në mënyrë të përmbledhur, kanë prapësuar:

16.1. Deklarata noteriale është nënshkruar pa dijeninë e së ndjerës M.E., megjithëse ajo

konsiderohet bashkëpronare në pasurinë e përbashkët të vendosur gjatë martesës me kërkuesin, për rrjedhojë *procesi është i parregullt*. Deklarata noteriale bën fjalë për shitjen e kuotave të shoqërisë dhe merr përsipër kryerjen e veprimeve për tokën dhe objektin në një moment të dytë dhe deklarimi i saj si i pavlefshëm nënkupton kthimin e tyre dhe asetëve të shoqërisë “Amal” sh.p.k. të kërkuesit dhe familja e tij.

16.2. Nëpërmjet procesit të parregullt, shtetases M.E. i është cenuar *e drejta e pronës*, në pjesën takuese, por edhe është ngarkuar me një detyrim i cili tashmë u është transferuar trashëgimtarëve të saj, megjithëse ajo nuk ka marrë asnjë përfitim nga kontrata e shitjes së kuotave të shoqërisë. Kanë qenë vetë subjektet e interesuara që kanë njoftuar Gjykatën për rrethanën e ndarjes nga jeta të mamasë së tyre M.E.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

17. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pika 1, shkronja “I” dhe pika 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

18. Gjykata vëren se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në ankimin kushtetues, për rrjedhojë, si bartës i së drejtës kushtetuese për proces të rregullt ligjor, të



pretenduar të cenuar, provon interesin e tij të drejtpërdrejtë.

19. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata ka pohuar se në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës, individit duhet të shfrytëzojë në shkallët e sistemit gjyqësor të gjitha mjetet e lejueshme dhe mundësitë procedurale për vendosjen në vend të të drejtave të pretenduara të shkelura. Mjetet ligjore shterojnë kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimet nr. 7, datë 21.2.2023; nr. 10, datë 4.3.2021; nr. 56, datë 25.7.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Në rastin konkret, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, pasi ka shteruar mjetet e ankimit në formë e substancë dhe pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjykimit të zakonshëm. Procesi gjyqësor i kundërshtuar nga kërkuesi është përmbyllur me vendimin nr. 00-2022-3489, datë 23.11.2022 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, për rrjedhojë ai e plotëson këtë kriter.

21. Po kështu, kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, pasi vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë mban datën 23.11.2022, kurse ankimi kushtetues është dërguar nëpërmjet shërbimit postar në datën 23.3.2023, pra brenda afatit 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000.

22. Lidhur me legjitimitimin *ratione materiae*, kërkuesi ka pretenduar cenimin e parimit të sigurisë juridike dhe pritshmërive të ligjshme, parimin e gjykatës së caktuar me ligj, standardin e arsyetimit të vendimit, parimin e paanshmërisë dhe të barazisë përpara ligjit, si dhe të drejtën e pronës, të cilat hyjnë në juridiksionin e Gjykatës. Për sa i takon cenimit të parimit të barazisë përpara ligjit dhe të paanshmërisë, kërkuesi ka parashtruar se Gjykata e Lartë nuk ka marrë në shqyrtim dhe nuk u ka kthyer përgjigje pretendimeve dhe kërtimeve të tij, duke u treguar haptazi e njëanshme. Gjykata vëren se kërkuesi nuk ka paraqitur asnjë argument kushtetues në lidhje me këto parime, duke mos arritur të provojë nga pikëpamja kushtetuese cenimin e tyre. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se këto pretendime janë haptazi të pabazuara.

23. Ndërsa, në lidhje me pretendimet e tjera që i takojnë së drejtës për proces të rregullt ligjor, në

drejtim të parimit të sigurisë juridike dhe të pritshmërive të ligjshme, parimit të gjykatës së caktuar me ligj, standardit të arsyetimit të vendimit, si dhe së drejtës së pronës, Gjykata, duke mbajtur në konsideratë thelbin e argumenteve në të cilat ato mbështeten, çmon t'i analizojë në drejtim të parimit të sigurisë juridike të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e parimit të sigurisë juridike të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit

24. Kërkuesi ka pretenduar se Gjykata e Lartë ka anashkaluar detyrimin e vendosur me vendime gjyqësore përfundimtare, të cilat kanë urdhëruar kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme, duke cenuar parimin e sigurisë juridike dhe të pritshmërive të ligjshme. Për rrjedhojë, vendimi objekt kundërshtimi ka cenuar edhe të drejtën e pronës. Gjithashtu, Gjykata e Lartë nuk ka arsyetuar me hollësi përse vendimet e formës së prerë nuk janë tituj ekzekutivë dhe arsyet përse nuk lëshon urdhrin e ekzekutimit, si dhe nuk ka marrë në shqyrtim dhe nuk u ka kthyer përgjigje pretendimeve dhe kërtimeve të tij.

25. Subjekti i interesuar, Luljeta Hysolli, ka prapësuar se pretendimet e kërkuetit janë të pabazuara, pasi ai nuk mund të kërkonte lëshimin e urdhrin të ekzekutimit për një vendim në të cilin është në pozitën e debitorit dhe jo të kreditorit. Nëpërmjet këtij vendimi gjykatat nuk i kanë njohur asnjë të drejtë kërkuetit për kuotat e shoqërisë që administron hidrocentralin. Deklarata noteriale është konstatuar nga gjykatat si e pavlefshme, pasi kërkueti nuk e ka pasur asnjëherë pronësinë e tokës ose të hidrocentralit, për aq kohë sa ato janë në pronësi të shtetit. E ndjera M.E. ka qenë në dijeni të plotë të të gjitha veprimeve juridike të kryera për shitjen e kuotave të shoqërisë dhe deklaratës noteriale. Bazuar në vendimet gjyqësore të themelit të çështjes, kërkuesi dhe trashëgimtarët e së ndjerës M.E. kanë detyrimin për të paguar një shumë monetare.

26. Subjektet e interesuara, trashëgimtarët e shtetas M.E., kanë prapësuar se deklarata noteriale është nënshkruar pa dijeninë e kësaj të fundit, megjithëse ajo konsiderohet bashkëpronare në pasurinë e përbashkët të vendosur gjatë martesës me kërkuetin, për rrjedhojë procesi është i parregullt. Deklarata noteriale bën fjalë për shitjen e kuotave të



shoqërisë dhe merr përsipër kryerjen e veprimeve për tokën dhe objektin në një moment të dytë dhe deklarimi i saj si e pavlefshme nënkupton kthimin e kuotave dhe asetëve të shoqërisë “Amal” sh.p.k. të kërkuar dhe familja e tij. Gjykatat kanë cenuar të drejtën e pronës, në pjesën takuese të së ndjerës M.E., duke e ngarkuar me një detyrim, i cili tashmë u është transferuar trashëgimtarëve të saj, megjithëse ajo nuk ka marrë asnjë përfitim nga kontrata e shitjes së kuotave të shoqërisë.

27. Gjykata ka pohuar se parimi i sigurisë juridike nënkupton, ndërmjet të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit të shteti, institucionet e tij dhe tek aktet që ato nxjerrin. Në rastin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, siguria juridike nënkupton që kur gjykata ka vendosur përfundimisht për një çështje, vendimi i saj nuk duhet të vihet në dyshim. Kur vendimi ka marrë formë të prerë, ai është i detyrueshëm për palët, trashëgimtarët e tyre, për personat që tërheqin të drejta nga palët, për gjykatën që ka dhënë vendimin dhe për të gjitha gjykatat dhe institucionet e tjera (*shih vendimet nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 10, datë 13.2.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Për sa i takon standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës, Gjykata ka theksuar se ai është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Po kështu, Gjykata, në mënyrë konstante, ka pohuar se shqyrtimi i çështjes nga Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit nuk është vetëm një konstatim formal i paraqitjes së shkaqeve ligjore në rekurs, por konsiston në vlerësimin e këtyre shkaqeve dhe bazueshmërisë së tyre, duke analizuar materialet e dosjes gjyqësore (*shih vendimet nr. 5, datë 9.2.2023; nr. 2, datë 11.2.2021; nr. 8, datë 26.2.2015, të Gjykatës Kushtetuese*). Prandaj Gjykata ka pranuar arsyetimin në mënyrë të kufizuar të vendimeve të mospranimit të rekursit të Gjykatës së Lartë, pasi, në thelb, shpreh shkaqet e mospranimit të rekursit nga ana e kolegjeve të saj gjatë shqyrtimit paraprak të tij në dhomën e këshillimit (*shih vendimet nr. 2, datë 11.2.2021; nr. 21, datë 16.4.2015; nr. 37, datë 19.9.2011, të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Gjithashtu, në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se mënyra se si gjykatat e zakonshme kanë përcaktuar faktet dhe kanë interpretuar ligjin e zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes në shqyrtim përpara tyre nuk përbën lëndë kushtetuese. Kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit dhe problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (*shih vendimet nr. 38, datë 2.12.2021; nr. 6, datë 16.2.2021; nr. 9, datë 26.3.2018, të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Në rastin konkret, Gjykata vëren se në përfundim të procesit të parë gjyqësor të zhvilluar ndërmjet palëve për zgjidhjen e thelbit të mosmarrëveshjes, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar se për shkak të pavlefshmërisë së veprimit juridik të deklaratës noteriale, palët duhet të kthehen në gjendjen e mëparshme, pra kërkuar dhe bashkëshortja e tij detyrohen t'i paguajnë solidarisht Luljeta Hysollit shumën 19.900.000 lekë dhe hidrocentrali të kthehet në gjendjen që ishte para zhvillimit të këtyre veprimeve juridike (*shih paragrafin 30 të vendimit nr. 00-2022-2260 (337), datë 5.10.2022, të Gjykatës së Lartë*). Ndërkohë, Gjykata evidenton se dispozitivi i vendimit të gjykatës së shkallës së parë, i lënë në fuqi nga gjykata e apelit, ka vendosur konstatimin e pavlefshmërisë absolute të kontratës së shitjes mes palëve ndërgjyqëse nëpërmjet deklaratës noteriale të vitit 2007 dhe kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme, duke detyruar të paditurit Agim Elezi dhe M.E. t'i paguajnë solidarisht paditëses Luljeta Hysolli shumën 19.900.000 lekë.

31. Në këto kushte, kërkuar ka kërkuar lëshimin e urdhrit të ekzekutimit vetëm për pjesën e parë të vendimit nr. 1658, datë 25.7.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan në lidhje me kthimin e palëve ndërgjyqëse në gjendjen e mëparshme. Kërkesa është rrëzuar nga gjykata e shkallës së parë, e cila ka vlerësuar se dispozitivi i vendimit të mësipërm nuk përmban detyrimin për kthimin e hidrocentralit në posedim të kërkuar (*shih fagen 2 të vendimit të gjykatës së shkallës së parë*).

32. Edhe Gjykata e Apelit Durrës në arsyetimin e saj ka theksuar se cilësimi si titull ekzekutiv i një akti duhet të jetë shprehur në mënyrë eksplicite në



dispozitat përkatëse të ligjit procedural apo edhe të jetë pjesë e parashikimeve të ligjit specifik që rregullon një fushë të caktuar të marrëdhënieve juridike. Kjo cilësi nuk mund të përftohet në mënyrë interpretative apo me analogji, pra gjykata, duke zbatuar ligjin procedural në *stricto sensu*, nuk mund të konkludojë për veshjen e një akti me cilësinë e titullit ekzekutiv, duke marrë rolin e ligjvënësit. Sipas asaj gjykate, në titullin ekzekutiv nuk gjendet ndonjë detyrim i palëve ndërgjyqëse ndaj kërkuesit Agim Elezi, qoftë edhe në kuadrin e situatës juridike të kthimit të palëve në gjendjen e mëparshme, në kuptim të nenit 106, paragrafi i parë, të Kodit Civil dhe formaliteti gjatë gjykimit pa kontradiktoritet i shërben qëllimit final të realizimit të ekzekutimit të detyrimeve të përcaktuara në titullin ekzekutiv (*shih faqet 3–5 të vendimit të gjykatës së apelit*).

33. Në vijim, Gjykata e Lartë, me vendimin e kundërshtuar, nuk ka pranuar rekursin e kërkuesit, pasi ai nuk përmban shkaqe ligjore nga ato të parashikuara në nenin 472 të KPC-së. Kjo gjykatë ka arsyetuar se palëve iu është dhënë mundësia të shprehin qëndrimin e tyre për zgjidhjen e mosmarrëveshjes; gjykatat më të ulëta kanë respektuar dhe zbatuar drejt dispozitat e ligjit material dhe ato procedural, duke bërë një cilësim të drejtë të fakteve dhe rrethanave që lidhen me mosmarrëveshjen, kanë kryer një analizë juridike të plotë të provave dhe e kanë zgjidhur mosmarrëveshjen në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, si dhe nuk janë në kundërshtim me praktikën e kësaj gjykate (*shih paragrafin 15 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

34. Nisur nga sa më lart, Gjykata vëren se sikurse kanë arsyetuar edhe gjykatat e zakonshme gjatë procesit të lëshimit të urdhrit të ekzekutimit, pavarësisht se gjatë procesit të zgjidhjes së thelbit të mosmarrëveshjes është vendosur kthimi i palëve në gjendjen e mëparshme, në situatën faktike të rrethanave konkrete të çështjes ai përfshinte vetëm detyrimin monetar në ngarkim të kërkuesit dhe të bashkëshortes së tij, ndërsa pjesa tjetër e detyrimit kontraktual, që parashikonte kalimin e së drejtës së pronësisë së objektit të hidrocentralit nga kërkuesi te subjekti i

interesuar Luljeta Hysolli, nuk është realizuar, pasi rezultonte se kërkuesi nuk e dispononte këtë të drejtë. Në këtë kuptim, pretendimi i kërkuesit për pritshmëri të ligjshme që urdhri i ekzekutimit do të lëshohej nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk është i bazuar. Po në këtë drejtim, gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e apelit i kanë marrë në shqyrtim pretendimet e kërkuesit dhe u kanë kthyer përgjigje të arsyetuar atyre, duke vlerësuar se vendimi për të cilin ai kërkon lëshimin e urdhrit ekzekutiv nuk përmban detyrimin e kthimit të hidrocentralit në posedim të kërkuesit.

35. Edhe Gjykata e Lartë, pasi ka listuar shkaqet e rekursit të kërkuesit, në të cilat përfshihen edhe pretendimet në drejtim të disponimit për kthimin në gjendjen e mëparshme të palëve (*shih paragrafin 13 të vendimit të Gjykatës së Lartë*), megjithëse me një arsyetim të kufizuar, i ka marrë në shqyrtim dhe i ka vlerësuar ato. Kjo mënyrë arsyetimi, sikurse u përmend më lart, është tashmë e konsoliduar në praktikën e Gjykatës së Lartë, përderisa shpreh në thelb shkaqet e mospranimit të rekursit gjatë shqyrtimit të tij paraprak në dhomën e këshillimit. Prandaj Gjykata arrin në përfundimin se edhe në rastin në shqyrtim vendimi i Gjykatës së Lartë nuk cenon standardet kushtetuese të arsyetimit të vendimit gjyqësor.

36. Për më tepër, Gjykata konstaton se gjykata e apelit ka arsyetuar edhe cili është mjeti ligjor që duhet të përdorë kërkuesi për të realizuar të drejtën e tij, duke argumentuar se nëse kërkuesi ka pretendime në lidhje me detyrimet reciproke që rrjedhin si rezultat i zgjidhjes së pasojave të pavlefshmërisë së veprimit juridik, ka në dispozicion mekanizmat ligjorë të parashikuara në KPC për sqarimin apo interpretimin dhe plotësimin e vendimit gjyqësor të themelit të çështjes (*shih faqen 6 të vendimit të gjykatës së apelit*).

37. Bazuar në këtë analizë, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të sigurisë juridike të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit nuk është i bazuar,² sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj kërkesa e tij rrëzohet.

² Gjyqtarët Sonila Bejtja dhe Sandër Beci votuan për pranimin e këtij pretendimi me argumentin se Gjykata e Lartë, në përputhje me funksionin e saj si gjykatë ligji, duhet

të kishte analizuar dhe kthyer përgjigje pretendimit të kërkuesit për sa i përket kthimit të palëve në gjendjen e mëparshme.



PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 20.11.2023.

Shpallur më 20.12.2023.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Elsa Toska, Marsida Xhaferllari, Ilir Toska, Fiona Papajorgji, Marjana Semini, Genti Ibrahimi

Anëtar kundër: Sandër Beci, Sonila Bejtja

VENDIM

Nr. 68, datë 7.12.2023

**NË EMËR TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Elsa Toska	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;
Genti Ibrahimi	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Marsida Xhaferllari	anëtare.

me sekretare Belma Lleshi, në datën 7.12.2023 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 3 (L) 2023 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: Laureta Selimaj, përfaqësuar nga avokat Thomas Dhimolea, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në mungesë.

Prokuroria e Përgjithshme, përfaqësuar me autorizim nga prokurori Arqilea Koça.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 28, datë 22.11.2022, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

Konstatimi i cenimit të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm dhe përshpejtimi i procedurave të gjykimit.

BAZA LIGJORE: Neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Marsida Xhaferllari, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkeses, e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme, i cili ka kërkuar rrëzimin e kërkesës së kërkeses, konstatoi mungesën e parashtrimeve me shkrim të subjektit të interesuar, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (*MFE*), si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkesja Laureta Selimaj ka ushtruar detyrën e mjekes psikiatre në Spitalin Psikiatrik Vlorë. Në vitin 2015 ajo është proceduar penalisht për veprën penale “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal (*KP*). Gjatë procedimit penal, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 284, datë 10.6.2015, ka caktuar masën e sigurimit “Arresti në burg” ndaj saj, e cila është ekzekutuar menjëherë.

2. Vendimi është ndryshuar nga Gjykata e Apelit Vlorë, e cila, me vendimin nr. 289, datë 25.6.2015, ka caktuar masën e sigurimit “Arresti në shtëpi”. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 00-2015-2783, datë 5.11.2015, ka vendosur mospranimin e rekursit të prokurorit.

3. Në datën 30.9.2015 prokurori i çështjes ka dërguar çështjen në gjyq. Gjatë gjykimit në shkallë të



parë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 586/61-2015-4623, datë 16.11.2015, ka vendosur zëvendësimin e masës së sigurimit “Arresti në shtëpi” me atë të detyrimit për t’u paraqitur në Policinë Gjyqësore.

4. Në të dyja rastet e lehtësimit të llojit të masës së sigurimit (nga arresti në burg në arresti në shtëpi dhe më pas në detyrim për paraqitje), gjykatat kanë konsideruar rrethanat e veçanta ekonomike dhe familjare të kërkuases, e cila ishte e ve dhe ushtronte e vetme përgjegjësinë prindërore për dy fëmijë të mitur të vitlindjeve 2007 dhe 2010. Në datën 6.1.2016 kërkuësja është rikthyer në detyrë në Spitalin Psikiatrik Vlorë.

5. Në përfundim të gjykimit të themelit të çështjes, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 671, datë 22.11.2017, ka vendosur të deklarojë të pafajshme kërkuesen për veprën penale për të cilën akuzohej. Vendimi i pafajësisë është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr. 269, datë 3.5.2018.

6. Në këto rrethana, kërkuësja në datën 7.6.2018 ka paraqitur padi në gjykatë kundrejt MFE-së dhe organit të prokurorisë, me objekt kompensimin për burgim të padrejtë bazuar në ligjin nr. 9381, datë 28.4.2005, “Për kompensimin e burgimit të padrejtë” (*ligji nr. 9381/2005*). Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë, me vendimin nr. 1170, 4.10.2018, ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë, duke i njohur kërkuases burgimin e padrejtë, si dhe duke urdhëruar dëmshpërblimin e saj në shumat 24.000 (*njëzet e katër mijë*) lekë për 16 ditë paraburgim të padrejtë dhe 143.000 (*njëqind e dyzet e tre mijë*) lekë për 143 ditë arrest në shtëpi të padrejtë. MFE-ja ka paraqitur apel kundër vendimit dhe prej datës 16.1.2019 çështja është në pritje për t’u shqyrtuar nga Gjykata Administrative e Apelit.

7. Në datën 13.10.2022, kërkuësja, bazuar në nenet 399/2 e vijuese të Kodit të Procedurës Civile (KPC), ka paraqitur në Gjykatën e Lartë kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përsheptimin e gjykimit të çështjes në gjykatën e apelit, me pretendimin se gjykimi ende nuk kishte përfunduar edhe pse kishin kaluar 4 vjet e 4 muaj nga dhënia e vendimit në shkallë të parë.

8. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 28, datë 22.11.2022, ka vendosur rrëzimin e kërkesës, me arsyetimin se gjykata e apelit është në pamundësi objektive për ta gjykuar çështjen

brenda afatit ligjor, për shkak të volumit të lartë të çështjeve në gjykatë. Vendimi i është komunikuar kërkuases në datën 30.12.2022.

9. Në datën 11.4.2023 kërkuësja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual sipas objektit të tij, i cili, pas plotësimit me dokumentet e kërkuara sipas parashikimeve të nenit 27 të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar përfundimisht në datën 27.4.2023. Kolegji i Gjykatës në datën 13.6.2023 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

10. *Kërkuësja*, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar *e drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, pasi shqyrtimi i çështjes në shkallë të dytë ka tejkaluar afatin e arsyeshëm.

11. *Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme*, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar se pretendimi për cenimin e së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm është i pabazuar, pasi shpejtësia e kryerjes së veprimeve procedurale nuk duhet të dëmtojë cilësinë e procesit të rregullt dhe të vendimmarrjes.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuases

12. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e



së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraparak të kërkesës.

13. Në rastin në shqyrtim, Gjykata vlerëson se kërkesja, si bartëse e të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese, legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, pasi është palë ndërgjyqëse në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

14. Një kriter tjetër është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, i parashikuar nga neni 131, pika 1, shkronja “P”, i Kushtetutës dhe neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i ligjit nr. 8577/2000, që kërkon shfrytëzimin në rrugë normale të mjeteve juridike efektive, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe të frytshme për një çështje konkrete. Lidhur me kërkesat për konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, Gjykata, pas ndryshimeve që iu bënë KPC-së me ligjin nr. 38/2017, ka mbajtur qëndrimin se legjislacioni i brendshëm parashikon mjete juridike efektive që i ofrojnë individit rezultate konkrete për rivendosjen e kësaj të drejte kushtetuese. Në këtë kuptim, individit duhet t’u drejtohet gjykatave të zakonshme, në përputhje me parashikimet e KPC-së, dhe vetëm pasi të ketë shteruar garancitë e mbrojtjes që i ofrohen nga juridiksioni i zakonshëm gjyqësor, ai mund të vërë në lëvizje gjykimin kushtetues (*shih vendimet nr. 46, datë 3.10.2023; nr. 44, datë 26.9.2023; nr. 2, datë 17.2.2022, të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Gjykata vëren se kërkesja i është drejtuar asaj me ankim kushtetues individual, pasi ka paraqitur më parë kërkesë në Gjykatën e Lartë, në zbatim të neneve 399/5–399/6 të KPC-së, për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes së saj të regjistruar në atë gjykatë, kërkesë e cila është rrëzuar nga Kolegji Administrativ me vendimin nr. 28, datë 22.11.2022. Për rrjedhojë, i vetmi mjet në dispozicion i kërkesues për rivendosjen e së drejtës së pretenduar të cenuar është ankimi kushtetues individual.

16. Lidhur me afatin e paraqitjes së ankimit kushtetues individual, Gjykata konstaton se vendimi për rrëzimin e kërkesës për përshpejtimin e procedurave të gjykimit, i është komunikuar kërkesues në adresën e avokatit të saj, i cili është marrë në dorëzim prej tij në datën 30.12.2022 (sipas shënimit në dëftesën e komunikimit që mban datën

22.12.2022), ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në datën 11.4.2023. Në këto rrethana, Gjykata çmon se kërkesja legjitimohet edhe *ratione temporis*, pasi shkelja e pretenduar është vazhduese dhe ankimi kushtetues individual, pas shterimit të mjetit juridik në dispozicion, është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000.

17. Për sa i takon legjitimitet *ratione materiae*, kërkesja pretendon cenimin e së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, pretendim i cili hyn në juridiksionin kushtetues dhe do të analizohet në vijim.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për shqyrtimin e çështjes brenda një afati të arsyeshëm

18. Kërkesja pretendon se i është cenuar e drejta e gjykimit brenda afatit të arsyeshëm, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, pasi shqyrtimi i çështjes së saj në shkallë të dytë nuk ka përfunduar që prej datës 16.1.2019, duke tejkaluar afatin kohor të arsyeshëm të parashikuar në nenin 399/2, pika 1, shkronja “b”, të KPC-së.

19. Neni 42 i Kushtetutës parashikon, ndër të tjera, se kushdo për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të tij kushtetues dhe ligjorë ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka vlerësuar se kohëzgjatja e gjykimit, normalisht, llogaritet nga momenti i fillimit të procesit gjyqësor deri në dhënien e vendimit dhe se në kohëzgjatjen e përgjithshme të gjykimit nuk përjashtohen vonesat e shkaktuara nga zbatimi i reformës në drejtësi, pasi barra e këtyre vonesave nuk duhet të zhvendoset te palët ndërgjyqëse (*shih vendimet nr. 46, datë 3.10.2023; nr. 6, datë 16.2.2023; nr. 13, datë 26.5.2022, të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Në çështjen konkrete, Gjykata konstaton se mosmarrëveshja që po gjykohet nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm lidhet me lirinë personale, konkretisht me kompensimin e kërkesues për burgim të padrejtë përgjatë procedimit penal në ngarkim të saj, i cili ka përfunduar me vendim pafajësie. Procesi gjyqësor i kompensimit ka filluar në shkallë të parë në datën 7.6.2018 dhe pas dhënies së vendimit në favor të kërkesues nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, subjekti i interesuar, MFE-ja, ka paraqitur apel. Si rezultat, çështja është regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit në



datën 16.1.2019 dhe ndonëse kanë kaluar pothuajse 5 vjet, ende nuk ka një vendimarrje për të.

21. Duke iu referuar objektit të mosmarrëveshjes gjyqësore, Gjykata vëren se neni 399/2, pika 1, shkronja “a”, i KPC-së ka përcaktuar se përbën afat të arsyeshëm përfundimi i gjykimit administrativ në gjykatën e apelit brenda një viti. Kjo do të thotë se gjykimi i çështjes konkrete në Gjykatën Administrative të Apelit është tejzgjatur, ndaj për të vlerësuar nëse kohëzgjatja e saj është e paarsyeshme, pra nëse kërkueses i është cenuar e drejta kushtetuese e procesit të rregullt në këtë aspekt, Gjykata do të analizojë rrethanat e veçanta të çështjes konkrete dhe kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese që lidhen me: i. sjelljen e kërkuesit; ii. kompleksitetin e çështjes; iii. sjelljen e autoriteteve; iv. rëndësinë e asaj çfarë rrezikon kërkuesi (*shih vendimet nr. 46, datë 3.10.2023; nr. 6, datë 16.2.2023; nr. 13, datë 26.5.2022, të Gjykatës Kushtetuese*).

i. Sjellja e kërkuesit

22. Sipas jurisprudencës kushtetuese vlerësimi i sjelljes së kërkuesit është një element përcaktues i kohëzgjatjes së arsyeshme të gjykimit, duke u analizuar rrethanat nëse ai ka vepruar në përputhje me të drejtat procedurale, duke shfaqur ose jo interes të vazhdueshëm për gjykimin e çështjes brenda një afati sa më të përshtatshëm për të dhe nëse është bërë shkak ose ka shkaktuar vonesa në këtë drejtim (*shih vendimet nr. 6, datë 16.2.2023; nr. 37, datë 5.11.2021; nr. 35, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Gjykata vëren se kërkuesja, pasi ka pritur dhe ka konstatuar se nuk ishte planifikuar një datë për shqyrtimin e ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit, i është drejtuar fillimisht Gjykatës së Lartë me kërkesën e regjistruar në datën 13.10.2022, për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave, në përputhje me parashikimet e neneve 399/1 e vijuese të KPC-së. Kjo kërkesë është rrëzuar nga Gjykata e Lartë në datën 22.11.2022 dhe sërish çështja ka mbetur pa veprime, në pritje të planifikimit për një datë shqyrtimi. Kërkuesja, pasi është njohur me vendimin e Gjykatës së Lartë, ka paraqitur ankim kushtetues individual, sipas objektit. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se sjellja e kërkueses nuk është bërë shkak për tejzgjatjen e gjykimit të çështjes së saj.

ii. Kompleksiteti i çështjes

24. Kërkuesja pretendon se çështja nuk paraqet kompleksitet, pasi është me natyrë procedurale dhe pretendimet e ngritura në apelin e subjektit të interesuar lidhen me përllogaritjen matematikore të vlerës së kompensimit për burgim të padrejtë sipas ligjit nr. 9381/2005.

25. Gjykata ka theksuar se në vlerësimin e kompleksitetit të çështjes marrin rëndësi të gjitha aspektet e saj, përfshirë objektin, faktet e kundërshtuara, volumi dhe natyra e provave, lloji dhe ndërthurja e ligjeve të zbatueshme, si dhe numri i palëve pjesëmarrëse në proces. Kohëzgjatja e konsiderueshme e gjykimit mund të justifikohet nga kompleksiteti i çështjes, sepse balancohet nga parimi i administrimit të përshtatshëm të drejtësisë (*shih vendimet nr. 6, datë 16.2.2023; nr. 13, datë 26.5.2022; nr. 35, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Nga shqyrtimi i dosjes gjyqësore konstatohet se çështja ka natyrë administrative, pasi ajo ka vetëm një kërkim, atë të kompensimit për burgim të padrejtë, bazuar në ligjin nr. 9381/2005. Si rregull, ky kërkim përfshin përcaktimin e kohës së burgimit të padrejtë bazuar në vendimet gjyqësore të dhëna në procedimin penal dhe më pas llogaritjen e vlerës së kompensimit sipas kriterëve të ligjit nr. 9381/2005. Gjithashtu, Gjykata vëren se gjykimi në shkallë të parë është zhvilluar në seancë gjyqësore publike, në bazë të provave shkruesore dhe se, krahas kërkueses në gjykim janë thirrur si palë ndërgjyqëse MFE-ja dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë ka zhvilluar tri seanca gjyqësore dhe ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim MFE-ja, e cila ka ngritur si shkak zbatimin e ligjit lidhur me vlerën e kompensimit, duke pretenduar se vlера duhet të përshtatet sipas veçorive të rastit konkret.

27. Duke iu referuar aspekteve të mësipërme, Gjykata çmon se çështja e kërkueses nuk paraqitet komplekse që të justifikojë kohëzgjatjen e shqyrtimit të saj prej pothuajse 5 vjetësh në shkallë të dytë.

iii. Sjellja e autoriteteve

28. Kërkuesja ka parashtruar se Gjykata e Lartë e ka rrëzuar kërkesën e saj për konstatimin e shkeljes dhe përshpejtimin e procedurave për faj të autoriteteve ligjzbatuese, të cilat nuk kanë marrë masat e nevojshme për të shmangur tejzgjatjet e proceseve, duke i ngarkuar kërkueses barrën e vonesave të shkaktuara nga reforma në drejtësi.



29. Në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së vendosin detyrimin për organizimin e sistemit ligjor të vendit në mënyrë të tillë që gjykatat të plotësojnë kërkesat e standardeve për proces të rregull ligjor, përfshirë këtu edhe atë të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm (*shih vendimet nr. 6, datë 16.2.2023; nr. 2, datë 17.2.2022; nr. 35, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese*). Pa mohuar nevojën, rëndësinë dhe përfitimet që sjellin reformat në sektorin e drejtësisë, Gjykata ka theksuar se ligjvënësi ka për detyrë të marrë masat dhe të gjejë mjetet e duhura për ndryshimin e gjendjes faktike, me qëllim që ligjet të zbatohen dhe gjykatat e të gjitha niveleve të funksionojnë normalisht. Pavarësisht se ka disa metoda që mund të zbatohen nga vetë gjykatat për të nxitur përkohësisht përsheptimin e gjykimit të çështjeve, nëse edhe masa të tilla nuk rezultojnë efektive dhe tejzgjatja e procedurave kthehet në problem të organizimit strukturor, atëherë shteti duhet të ndërhyjë me miratimin e masave më efektive dhe të organizojë sistemin gjyqësor, në mënyrë që të garantohet e drejta për të marrë një vendim përfundimtar brenda një afati të arsyeshëm (*shih vendimet nr. 2, datë 17.2.2022; nr. 37, datë 5.11.2021; nr. 35, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Në këtë kuptim, shteti është përgjegjës për të gjitha autoritetet shtetërore, përfshirë organet gjyqësore, sepse neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së kërkojnë që procedurat gjyqësore të jenë të shpejta, duke vënë theksin në parimin e përgjithshëm të administrimit të duhur të drejtësisë. Megjithatë, një mbingarkesë kronike nuk mund të justifikojë zgjatjen e tepërt të procedurave. Nëse një situatë e tillë zgjatet dhe bëhet çështje organizimi strukturor, metoda të tilla nuk janë më të mjaftueshme dhe shteti duhet të sigurojë miratimin e masave efektive. Fakti që situata të tilla me çështje të prapambetura janë bërë të zakonshme nuk justifikon zgjatjen e tepërt të procedurave (*shih vendimin nr. 46, datë 3.10.2023, të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Duke iu referuar rrethanave të çështjes konkrete, Gjykata vëren se shqyrtimi i ankimit në çështjen e kërkuar është në pritje për shqyrtim prej pothuajse 5 vjetësh në Gjykatën Administrative të Apelit. Ndërkohë, Gjykata e Lartë ka rrëzuar kërkesën për konstatimin e shkeljes dhe përsheptimin e procedurave, duke vlerësuar se mosveprimi i gjykatës nuk ka ndodhur për shkak

subjektive që lidhen me vlerësime dhe qëndrime abuzive të gjyqtarit. Sipas Gjykatës së Lartë, gjykata e apelit është në pamundësi objektive për të gjykuar çështjen e kërkuar brenda afatit të arsyeshëm, për shkak të ngarkesës së madhe dhe akumulimit ndër vite të çështjeve në atë gjykatë.

32. Gjykata rithekson se interpretimi i ligjit dhe zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues (*shih vendimet nr. 5, datë 1.3.2018; nr. 23, datë 20.4.2016; nr. 62, datë 23.9.2015, të Gjykatës Kushtetuese*). Megjithatë, Gjykata, duke bërë një vlerësim të natyrës kushtetuese, ndërhyr në ato raste kur gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, përmes interpretimit të ligjit në një çështje konkrete, kanë cenuar të drejtat kushtetuese të palëve (*shih vendimet nr. 3, datë 23.2.2016; nr. 62, datë 23.9.2015; nr. 16, datë 19.4.2013, të Gjykatës Kushtetuese*).

33. Për sa më lart, Gjykata, duke njohur kompetencën kushtetuese të Gjykatës së Lartë për interpretimin e ligjit sipas nenit 141 të Kushtetutës, çmon se duhet kontrolluar nëse interpretimi që ajo i ka bërë nenit 399/2 të KPC-së ka respektuar standardet kushtetuese të procesit të rregullt ligjor, në aspektin e gjykimit brenda afatit të arsyeshëm. Në këtë kontekst, Gjykata evidenton se argumenti kryesor, i cili qëndron në thelb të interpretimit ligjor të Gjykatës së Lartë për “*pamundësinë objektive*”, lidhet me efektet e zbatimit të reformës në drejtësi në drejtim të volumit të lartë të çështjeve që po përballon sistemi i drejtësisë, përfshirë Gjykatën Administrative të Apelit.

34. Duke analizuar gjendjen e Gjykatës Administrative të Apelit, në datën 16.1.2019, kur çështja e kërkuar është regjistruar, reforma në drejtësi kishte filluar të zbatohet. Aktualisht, reforma është ende në proces zbatimi dhe çështja e kërkuar vijon pa vendimarrje, ndërsa numri i gjyqtarëve të Gjykatës Administrative të Apelit është nën organikën e saj, gjithsej, 9 gjyqtarë. Gjykata Administrative e Apelit informon me shkrim se ngarkesa e çështjeve është nga 1279 deri në 2760 çështje në shqyrtim për çdo gjyqtar. Gjyqtarja relatore, së cilës i është caktuar për shqyrtim së fundmi çështja e kërkuar, ka për shqyrtim 2760 çështje gjyqësore. Aktualisht në Gjykatën Administrative të Apelit janë duke u shqyrtuar çështjet e regjistruara në vitin 2017. Po kështu, Gjykata Administrative e Apelit informon se ajo ka



për shqyrtim 560 çështje të ngjashme me ato të kërkuases, të regjistruara përgjatë periudhës 2017-2023.

35. Gjithashtu, nga dokumentacioni i përcjellë nga Gjykata Administrative e Apelit, Gjykata konstaton se çështja e kërkuases, e regjistruar në datën 16.1.2019, i është caktuar me short 5 gjyqtarëve, konkretisht në datat 18.1.2019, 10.7.2020, 19.5.2022, 9.3.2023 dhe 14.9.2023, për shkak të organizimit të brendshëm të punës në atë gjykatë. Përveç organizimit të shorteve dhe lëvizjes së çështjes nga njëri gjyqtar relator tek tjetri, nuk rezultojnë të jenë kryer veprime të tjera me çështjen.

36. Duke i analizuar treguesit e mësipërm, Gjykata çmon se vonesa në gjykimin e çështjes së kërkuases është pasojë e ngarkesës së lartë në Gjykatën Administrative të Apelit dhe të gjyqtarës relatore, shkaktuar nga zbatimi i reformës në drejtësi. Kjo gjendje është duke zgjatur prej disa vitesh dhe metodat e identifikuar nga vetë gjykatat dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor, në cilësinë e organit kushtetues që ka përgjegjësinë për të siguruar mbarrëvajtjen e pushtetit gjyqësor (neni 147, pika 1, i Kushtetutës), tregojnë se mekanizmat e parashikuar nga nenet 399/1-399/12 të KPC-së i shërbejnë një kohe normale të veprimtarisë gjyqësore, pra jo situatës së jashtëzakonshme, në pikëpamje të volumit, që ndodhet tashmë sistemi i drejtësisë.

37. Në këto rrethana, Gjykata, bazuar në standardet kushtetuese të mësipërme, vlerëson se interpretimi i ligjit nga Gjykata e Lartë për rrëzimin e kërkesës për konstatimin e shkeljes dhe përshpejtimin e procedurave të gjykimin të çështjes së kërkuases në shkallë të dytë nuk është në përputhje me Kushtetutën, ndaj vendimi i saj duhet shfuqizuar. Gjykimi përtej afatit të arsyeshëm, bazuar vetëm në faktin se shteti ka dështuar të marrë masa efikase, nuk mund të përligjë cenimin e të drejtave kushtetuese të individëve, në kushtet kur mbingarkesa në gjykata tashmë është një situatë e njohur dhe e zgjatur në kohë, e cila nuk varet nga individët. Në këtë pikë, Gjykata eidenton se sjellja e autoriteteve shtetërore, në veçanti e atyre që miratojnë ligjet dhe politikat e sistemit të drejtësisë, nuk është në nivelin e duhur të efikasitetit, pasi bën të nevojshme ndërhyrje të mëtejshme, veçanërisht legjislative, për të shmangur vonesat e paarsyeshme të gjykimin të çështjeve në gjykata, në kushtet kur mjetet ligjore ekzistuese nuk i përgjigjen situatës aktuale.

iv. Rëndësia e asaj çfarë rrezikon kërkuasi

38. Gjykata ka pohuar se disa kategori çështjesh, për shkak të natyrës së tyre, kërkojnë përshpejtim të posaçëm të gjykimin. Në këto raste duhet të merret parasysh rëndësia e asaj çfarë rrezikon kërkuasi në procesin gjyqësor, pra rëndësia që ka për të e drejta objekt gjykimi. Kjo do të thotë se disa çështje që lidhen me interesa “vetjakë e jetësorë”, lipset të trajtohen me përparësi dhe shpejtësi të veçantë. Lista e këtyre çështjeve nuk mund të jetë shteruese dhe verifikimi i kriterit të interesit të kërkuasit në proces verifikohet nga Gjykata rast pas rasti (*shih vendimet nr. 6, datë 16.2.2023; nr. 35, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

39. Duke iu kthyer çështjes konkrete, Gjykata vëren se, ashtu siç kanë pohuar gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, rrethanat familjare të kërkuases janë të veçanta. Ajo është e ve dhe ushtron e vetme përgjegjësinë prindërore për dy fëmijë të mitur, të vitlindjeve 2007 dhe 2010. Nga ana tjetër, Gjykata konstaton se çështja e kërkuases lidhet me kompensimin për burgimin e padrejtë të saj gjatë procedimit penal. E drejta e kompensimit të saj gjen mbrojtje specifike edhe nga neni 5, pika 5, i KEDNJ-së, që parashikon shprehimisht “çdo person që arrestohet ose burgoset në kundërshtim me dispozitat e këtij neni ka të drejtën për të kërkuar dëmshpërblim”. Lidhur me këtë të drejtë, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka pohuar se kompensimi duhet të garantohet si në teori (*shih vendimet e GJEDNJ-së Dubovik kundër Ukrainës, 2009, § 74; Chitayev dhe Chitayev kundër Rusisë, 2007, § 195*). Në këto rrethana, Gjykata çmon se çështja është e një natyre të tillë, që vonesa në shqyrtimin e çështjes në vetvete e bën joefektiv mjetin juridik të kompensimit të cenimit të lirisë personale.

40. Në përfundim, duke pasur parasysh kohëzgjatjen prej pothuajse 5 vjetësh të shqyrtimit të ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit, kompleksitetin e ulët të çështjes, sjelljen e autoriteteve, si dhe rëndësinë e së drejtës së pronës, Gjykata vlerëson se kërkuases i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor në aspektin e kohëzgjatjes së paarsyeshme të gjykimin, ndaj kërkesa duhet të pranohet. Po kështu, bazuar në nenin 81, pika 3, të ligjit nr. 8577/2000 dhe duke mbajtur në konsideratë ngarkesën e punës së Gjykatës Administrative të Apelit dhe volumin e çështjeve të ngjashme me ato të kërkuases, Gjykata çmon se duhet urdhëruar shqyrtimi i ankimit me



përparësi për çështjen e kërkuases, pa pritur radhën sipas kohës së regjistrimit të saj.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “Y”, të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.
 2. Shfuqizimin e vendimit nr. 28, datë 22.11.2022, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
 3. Konstatimin e cenimit të së drejtës për proces të rregullt ligjor në aspektin e së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm.
 4. Detyrimin e Gjykatës Administrative të Apelit të shqyrtojë çështjen e kërkuases me përparësi.
- Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 7.12.2023.

Shpallur më 21.12.2023.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Elsa Toska, Fiona Papajorgji, Ilir Toska, Sandër Beci, Sonila Bejtja, Marsida Xhaferllari, Marjana Semini, Genti Ibrahim

URDHËR
Nr. 290, datë 27.12.2023

PËR DELEGIM TË PËRKOHSHËM
KOMPETENCASH

Në mbështetje dhe në zbatim të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të nenit 12, pika 1 dhe nenit 13, germa “b”, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të nenit 7, pika 2, germa “c”, të rregullores “Për veprimtarinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit të Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar, në mungesë të Kryetarit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të Kryetarit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, gjyqtarës Mimoza Tasi, për periudhën 3.1.2024–5.1.2024. Kjo kompetencë nuk mund të nëndelegohet.
 2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet gjyqtarja Mimoza Tasi dhe të gjithë punonjësit e Kolegjit të Posaçëm të Apelit.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR I KOLEGJIT TË POSAÇËM
TË APELIMIT
Sokol Çomo

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2023

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 432 lekë